





# Analiza Krahasuese

## Arsimi paqësor

### 2011-2019

Mars 2020

**Titulli:** Analiza Krahasuese Arsimi paqësor 2011 - 2019

**Botues:** Ambasada e parë e fëmijëve në botë “Megjashi” Rr. Kosta Novakoviç nr.22a 1000 Shkup

**Telefoni:** +3892 2465316

**e-mail:** info@childrensembassy.org.mk; peace@childrensembassy.org.mk

**Për botuesin:** M-r Dragi Zmijanac, president dhe themelues

**Redaktore:** Ana Bitoljanu, Fatmire Ajdari dhe Gordana Pirkovska Zmijanac

**Formimi grafik:** “Invento”

**Përkthyes nga maqedonishtja:** Veton Kodra

**Shtypi:** “Invento”

# Përmbajtja

1. Hyrje .....	5
2. Analiza e profilit sociodemografik të nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave në shkollat e mesme .....	7
3. Pasqyra e përgjithshme për perceptimin e klimës së përgjithshme të marrëdhënieve në mes nxënësve/eve në shkollat e mesme.....	10
4. Klima ndëretnike në shkolla (2011- 2019) .....	17
5. Dhuna adoleshente (në mes bashkëmoshatarëve) – bullingu dhe forma tjera të sjellsjes së dhunshme .....	20
6. Perceptimi i rrahjeve nga ana e nxënësve/eve (2019) .....	32
7. Shkaqet për dhe qëndrimi ndaj sjellsjes së dhunshme (2019).....	34
8. Masat për përmirësimin e mirëkuptimit në mes nxënësve/eve prej grupeve të ndryshme etnike (2019) .....	40
9. Viktimat e dhunës (2011 – 2019) .....	43
10. Masat të cilat duhet të ndërmerren ndaj dhunuesve në shkolla (2019).....	46
11. Arsyetimi i përdorimit të dhunës në zgjidhjen e problemeve në shoqëri (2011 - 2019) .....	47
12. Të kërkuarit e ndihmës pas përjetimit të dhunës (2019) .....	49
13. Masat për zvogëlimin e dhunës në shkolla .....	52
14. Vlerësimi për rritjen / zvogëlimin e dhunës në shkolla (2019).....	57
15. Përmbledhja e gjetjeve kryesore prej hulumtimeve .....	58
Shtojcë 1 Pyetësor për nxënës .....	60
Shtojcë 2 Pyetësor për profesorë/esha .....	67
Shtojca 3 Përgjigjet e nxënësve/eve në pyetjen: B14. “Sipas mendimit tënd çka duhet të ndërmerret në shkollë me qëllim që të zvogëlohet dhuna në mes bashkëmoshatarëve?“ .....	72

## Programi për arsim paqësor

Ambasada e parë e fëmijëve në botë- Megjashi filloi me implementimin e Programit për arsim paqësor në vitin 2011. Duke e promovuar paqen dhe jodhunën si vlera themelore në sistemin edukativo-arsimor, donim të theksojmë nevojën për integrim më intenziv të Arsimit paqësor në kurrikulat mësimore. Edukimi për paqen është pjesë përbërëse e edukimit dhe arsimit për qytetari demokratike dhe ajo bazohet në nevojën për parandalim nga dhuna dhe konflikte të reja të mundshme.

Implementimi i Programit për arsim paqësor në masë të madhe varet nga interesimi i kuadrit mësimdhënës në vetë shkollat. Në vitet e kaluara, programit iu bashkangjiten më shumë shkolla të mesme nga disa qytete të vendit – Vinicë, Veles, Gostivar, Dibër dhe Shkup. Gjithnjë e më shpesh bashkangjiten shkolla të reja me kërkesën e tyre, por vëmendje e vazhdueshme i kushtohet forcimit të kapacitetit të shkollave tashmë të përfshira në program. Për kuadrin mësimdhënës të përfshirë në program, vazhdimisht organizojmë trajnime në tema të ndryshme, procesi i edukimit nuk përfundon kurrë, trajnimet janë vende inspirim, ndarje dhe mësim nga njëri/a-tjetri/a.

Profesorë dhe profesoresha të përfshirë në program kanë për detyrë të organizojnë aktivitete paqësore në shkolla me nxënës/nxënëset, duke krijuar përmbajtje nëpërmjet të cilave të rinjtë në mënyrë aktive do të përfshihen në ndërtimin e paqes në shkollat e tyre, por edhe më gjerë. Nëpërmjet aktiviteteve paqësore sensibilizohen nxënës/nxënëset për pyetje nga fusha e komunikimit dhe për zgjidhjen e konflikteve në mënyrë të padhunshme, njohjen e llojeve të ndryshme të dhunës, pranimin e diversitetit, përfshirjen në procese të vendimmarrjes, qytetari aktive, solidaritet global, etj, ose të iniciojnë aktivitete si për shembull, Forum teatër, aktivitete ekologjike dhe të ngajshme. Në përgjithësi, aktivitetet kanë për qëllim t'i inkurajojnë të rinjtë të marrin qëndrim aktiv në mjedisin e tyre, pa dhunë dhe me vetëdije për llojet e shumta të padrejtësive, diskriminime dhe dhunë, duke u përçarur aftësi dhe njohuri të cilat janë të rëndësishme për ndërtimin e paqes, organizimit qytetar dhe veprimit të padhunshëm.

Në vitin 2018 nëpërmjet Programit për arsim paqësor filloi bashkëpunimi me Ministrinë e arsimit dhe shkencës, kurse në vitin 2019 u nënshkrua memorandumimi për bashkëpunim ndërmjet MASH dhe APFB Megjashi. U organizuan më shumë trajnime në të cilat përfaqësuesit/përfaqësueset e MASH kishin mundësi nëpërmjet pjesëmarrjes personale të njihen më mirë me Programin për arsim paqësor, temat të cilat përpunohen, metodologjia e punës, aktivitetet të cilat realizohen në shkolla, por edhe të japin kontributin dhe sugjerimet e tyre për aktivitetet lidhur me ndërtimin e paqes. Përmes marrëveshjes dhe bashkëpunimit me MASH në vitin shkollor 2018/2019 aktivitetet e Programit për arsim paqësor të cilat u realizuan në shkolla u realizuan në kuadër të Pilot- programit për arsim paqësor të vitit 2018/2019.

Përmes Programit për arsim paqësor duam të kontribuojmë në zvoglimin e dhunës në shkolla dhe forcimin e kapaciteteve të profesorëve/ profesorehave dhe nxënësve/nxënëseve në drejtim të tejkalimit të konflikteve, duke i përpunuar të njëjtat në mënyrë të padhunshme. Gjendja me dhunën në shtet është më se shqetësuese, kurse marrëdhëniet ndëretnike edhe më tej mbeten të brishta. Një nga vështirësitë në trajtimin e dhunës të bashkëmohatarëve është mungesa e të dhënave përkatëse për dhunën në shkolla. Prandaj u paraqit nevoja ta realizojmë hulumtimin që është para nesh. Rezultatet e marra në kuadër të hulumtimit mund të japin një pasqyrë pjesërisht të një panorame më të gjerë për gjendjen në shkollat e mesme në nivel të gjithë shtetit, të ndihmojë edhe në analizat e kësaj problematike në nivel shtetëror, por, para së gjithash ne na intersojnë marrëdhëniet ndëretnike dhe përfaqësimi i dhunës në shkollat të cilat janë të përfshira në Programin për arsim paqësor. Hulumtimi jep një pasqyrë për gjendjen në shkolla dhe do të ndihmojë në hartimin e aktiviteteve konkrete në shkolla. Hulumtimi, gjithashtu, është informacion kthesë nga nxënës/nxënëset dhe është hap përpara në përfshirjen e nxënësve/nxënëseve në procesin e vendimmarrjes në shkolla, dhe të dëgjohet edhe zëri i tyre jo vetëm që është e rëndësishme por është edhe thelbësore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta.

Në fund, dëshirojmë që Arsimi paqësor tërësisht të bëhet pjesë përbërëse e sistemit edukativo - arsimor. Para nesh është një proces i gjatë i ndërtimit të shoqërisë e cila do të reagojë ndaj të gjitha llojeve të dhunës, kurse dallimet nuk do t'i perceptojë si kërcënim.

Programi për arsim paqësor implementohet me mbështetje të vazhdueshme nga organizata partnere KURVE Wustrow nga Gjermania dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë Federale Gjermane për bashëpunim dhe zhvillim ekonomik.

Ne dëshirojmë t'i falënderojmë shkollat dhe kuadrin mësimdhënës për ndihmën dhe sinqeritetin e tyre për kryerjen e hulumtimit.

*Ekipi i Programit për arsim paqësor, APFB Megjashi*

# 1. Hyrje

## Metodologjia

Ambasada e parë e fëmijëve në botë MEGJASHI, në bashkëpunim me BRIMA - Agjencinë për hulumtime të opinionit publik dhe tregut, kreu tre hulumtime nga anketa për Programin e arsimit paqësor. Këta anketa janë realizuar në bashkëpunim me ekipet e projektit të Megjashit dhe mbështetjen profesionale nga ekipet e BRIMA. Në fokus të hulumtimit ishin temat në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike, dhunën ndëretnike dhe dhunën në përgjithësi ("bullingu" si një dukuri që po bëhet gjithnjë e më e përhapur vitet e fundit) në shkollat e mesme.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është të shihen efektet e arritura përmes realizimit të projektit Arsimi paqësor dhe gjithashtu të mundësohet analizimi i faktorëve të cilët ndikojnë në realizimin e Programit për arsimpaqësor në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për të siguruar një bazë të dhënash për një analizë të tillë, u realizuan tre anketa nga viti 2011 deri në vitin 2019. Këto studime në masë të madhe janë të lidhura, për shkak të mënyrës mbizotëruese të hulumtimit dhe ngjashmërisë të shumë prej pyetjeve, edhe pse rezultatet duhet të shihen më shumë nga këndvështrimi i indikacionit të një fenomeni të caktuar gjatë krahasimit të tyre.

Për të arritur këto qëllime, u përgatit një plan hulumtues dhe u hartua një pyetësor i mostrës të hulumtimit.

Në vitin 2011 dhe 2012, sipas planit, hulumtimi është realizuar në dy faza. Në fazën e parë fillestare, të dhënat u mbledhën me qëllim të "regjistrimit" të situatës për sa i përket parametrave që përcaktojnë grupin e caktuar të pyetjeve të cilat kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të Arsimit paqësor në shkollat e mesme. Me anketimin e përsëritur u fitua "regjistrimi" i ndryshimeve në të njëjtat parametra që ndodhën në periudhën në mes këtyre dy hulumtimeve (korniza e periudhës kohore është një vit - vjeshta 2011 vjeshta 2012).

Në kuadër të këtij plani:

- Anketa e parë është realizuar në periudhën nëntor - dhjetor të vitit 2011 dhe në këtë hulumtim janë anketuar 370 nxënës/e nga 5 shkolla të mesme në territorin e qytetit të Shkupit.
- Anketa e dytë është realizuar në gjysmën e parë të muajit dhjetor të vitit 2012 dhe në këtë hulumtim janë anketuar 325 nxënës nga 5 shkolla të mesme në territorin e qytetit të Shkupit.

Edhe në anketën e parë edhe në të dytën janë anketuar të njëjtët nxënës/e që të mund të analizohen ndryshimet aktuale të cilat ndodhën midis dy hulumtimeve për sa i përket parametrave të hulumtimit (shënim: përfshierja grupit të dytë të studimit të nxënësve në proporcion me valën e parë është më i vogël për 45. Kjo "prishje" e mostrës fillestare është dukuri e zakonshme në këtë lloj të hulumtimeve).

Me qëllim që të realizohet një shqyrtim, se çfarë dhe sa është ndikimi i kontekstit të ndryshëm socio-demografik në shkollat mbi efektet e Programit për arsim paqësor, anketa u realizua në 3 shkolla të mesme me strukturë socio-demografike heterogjene<sup>1)</sup> dhe 2 shkolla me strukturë socio-demografike homogjene.

Pyetësori i anketës ishte identik në të dy hulumtimet dhe përbëhet nga 21 pyetje (thelbi i pyetësorit) dhe 7 pyetje demografike. Në anketën e dytë, u parashtua një pyetje shtesë lidhur me vlerësimin nëse prania e dhunës në shkollë ka ndryshuar në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu në interes të evidentimit më të saktë të anëtarëve aktual dhe të mëparshëm të Klubit rinor të paqës<sup>2)</sup>, në pyetjen e parashtuar, a je anëtar i klubit rinor të paqës... u shtua kategori e re si opcion për t'u përgjigjur...*isha por nuk jam më anëtar*.

Plani për hulumtimin e tretë u realizua në disa shkolla ku përveç qytetit të Shkupit, u kyçën edhe shkolla nga qytete të tjera, të cilat gjithashtu, janë të përfshira me Programin e Megjashit për arsimin

<sup>1)</sup> Në tekstin e më tutjeshëm të analizës, shkollat në të cilat arsimohen nxënës nga të gjitha grupet etnike në Maqedoni - maqedonas, shqiptarë dhe pjesëtarë të bashkësive të tjera etnike, do t'i etiketojmë shkurtimisht si socio-demografike heterogjene (duke shënuar në tabelat si-Shkolla (M + dhe shqiptarë)), ndërsa shkollat në të cilat arsimohen maqedonas dhe anëtarë të bashkësive të tjera do të shënohen si socio-demografike homogjene (duke shënuar në tabelat si - Shkolla M + (maqedonasit dhe të tjerët) / shkolla A (shkollë vetëm shqiptarët)).

<sup>2)</sup> Klubi rinor për paqe është aktivitet jashtëshkollor në të cilin janë të përfshirë nxënësit/et, profesorët/eshat dhe persona profesionist nga Megjashi përgjegjës për edukimin dhe zbatimin e Arsimit paqësor.

paqësor. Që nga fillimi i këtij projekti e deri më sot, theksi kryesor është tek trajnimi i vazhdueshëm i profesorëve në tema të ndryshme të organizuara në kuadër të Programit për arsim paqësor (trajnime fill-estare dhe të avancuara për ndërtimin e paqes dhe arsimin paqësor, trajnime për temat gjinore dhe gjininë, dhuna e bashkëmoshatarëve, etj). Në hulumtimin më të ri nga viti 2019, përveç nxënësve, u anketuan edhe profesorët/eshat nga shkollat të cilët kanë qenë por edhe ato të cilët nuk kanë qenë pjesë e Arsimit paqësor, duke supozuar se të gjithë nxënësit e anketuar kanë qenë nën njëfarë ndikimi nga profesorët/eshat të cilët kanë zbatuar Arsimin paqësor në punën e tyre të përditshme.

Si rrjedhim, pyetësorët në këtë hulumtim ishin dy, të dizajnuar ndryshe dhe të destinuar për marrjen e të dhënave nga nxënësit/et dhe profesorët/eshat nga nëntë shkolla të mesme nga Shkupi, Velesi, Vinica, Dibra dhe Gostivari. Anketat u realizuan mes nëntorit dhe dhjetorit të vitit 2019 mbi gjithsej 400 nxënës dhe 87 profesorë/esha. Për më tepër, analiza e mëtutjeshme është në kahje të prezantimit të të gjitha rezultateve për vitin 2019 dhe përgjigjet e profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve, ndërsa në analizë do të ketë gjithashtu “krahasime” të të tre hulumtimeve, respektivisht këta krahasime do të jenë vetëm tek pyetjet identike të parashtruara në vitet 2011, 2012 dhe 2019. Për këtë arsye, krahasimet nga hulumtimi i vitit 2019 me hulumtimin e viteve 2011 dhe 2012<sup>3)</sup> duhet të merren si indikacion i caktuar për shkak të dallimeve strukurore në dizajnin të mostrës në mes hulumtimit të fundit më të ri dhe hulumtimeve paraprake si dhe dallimet në strukturat e pyetësorëve.

Parimi i zbatimit të anketës është me vetë-plotësim, dhe para fillimit të realizimit të anketës të anketuarit udhëzohen se mendimi i tyre personal është i rëndësishëm, se nuk ka përgjigje të gabuara dhe të sakta dhe se është e detyrueshme t’u përgjigjen të gjitha pyetjeve.

Të gjitha këtoelemente nga plani i hulumtimit, mostra dhe pyetësori mundësojnë që përmes analizës së rezultateve të marrat’i qasemi përcaktimit të faktorëve përkatës dhe relacionet e tyre të ndërsjella të cilat kanë ndikim mbi Programin e arsimit paqësor në shkollat e mesme të cilat janë të përfshira në hulumtim.

Duke marrë parasysh se analizohen përgjigjet a nxënësve/eve të cilët janë në fazën e maturimit psikologjik, adoleshencës, karakterisitike për këtë fazë të zhvillimit psikologjik është rebelimi ndaj autoriteteve, respektivisht kufizime në përpjekjet t’i integrojnë në personalitetin e tyre pikëpamjet personale ndaj çështjeve jetësore dhe marrëdhëniet në mes njerëzve. Pikërisht për këtë shkak njëri prej qëllimeve kryesore të Programit të arsimit paqësor duhet të jetë përpjekja për t’u dhënë përkrahje nxënësve/eve në procesin e integritetit të personit të shëndoshë në shoqëri. Prej shkaqeve të dhëna rrjedh se është objektive dhe paraqet sfidë të madhe të punohet me nxënësit/et e kësaj moshe posaçërisht kur bëhet fjalë për format e sjelljes së dhunshme. Për këtë shkak duhet të tejkalohet perceptimi që në ndonjë konotacion e japin të dhënat për Programin për arsimin paqësor se karakteristikat e kësaj popullate janë të tilla që e vështirëson pranimin e shpejtë të tërë asaj që vjen nga Programi i arsimit paqësor. Në një numër të caktuar të rasteve mund të pritet se në fazat e mëtutjeshme të zhvillimit të personalitetit, përvojat e fituara nëpërmjet Programit të arsimit paqësor do t’iu jetë një ndihmë shumë e vlefshme nxënësve/eve aktual gjatë procesit të suksesshëm të zhvillimit personal. Programi i arsimit paqësor duhet të vendoset në konotacion të hulumtimit longitudinal ku efektet nga Arsimi paqësor do të mund të vlerësohen shumë më realisht në një periudhë më të gjatë kohore.

## 2. Analiza e profilit sociodemografik të nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave në shkollat e mesme

Tabela 1

Shkolla - nxënës/e	2011		2012		2019	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
ShMQSh Gjinnazi “Nikolla Karev” Shkup	88	24	80	25	42	11
ShMQSh Gjinnazi “Orce Nikolov” Shkup	60	16	59	18	/	/
ShMMQSh “Dr. Pançe Karagjovov” Shkup	78	21	61	19	/	/
ShMQSh “Arseni Jovkov” Shkup	63	17	57	17	59	15
ShMNQSh “Zdravko Cvetkovski” Shkup	81	22	68	21	/	/
ShMQSh Gjinnazi “Zef Lush Marku” Shkup	/	/	/	/	53	13
ShMK “28 Nëntori” Dibër	/	/	/	/	40	10
ShMK Gjinnazi “Gostivari” Gostivar	/	/	/	/	59	15
ShMEK “Gostivar” - Gostivar	/	/	/	/	43	11
ShMPK “Dimitrija Çupovski” - Veles	/	/	/	/	29	7
ShMK “Gjinnazi Koço Racin” - Veles	/	/	/	/	41	10
ShMK “Vanço Përke” - Vinicë	/	/	/	/	34	9
Gjithsej	370	100%	325	100%	400	100%

Në vitin 2019 hulumtimi u realizua në nëntë shkolla prej të cilave tre janë në Shkup, një në Dibër, dy shkolla në Gostivar, dy në Veles, dhe një në Vinicë. Nga gjithsej nëntë shkolla, në tre shkolla mësojnë nxënës/e me përkatësi etnike maqedonase dhe përkatësi tjera etnike (i konsiderojmë si shkolla homogjene), një shkollë është me nxënës të përkatësisë etnike shqiptare (shkolla homogjene ShMQSh Gjinnazi “Zef Lush Marku”), ndërsa të gjitha të tjerat janë “heterogjene”, respektivisht mësojnë nxënës/e me përkatësi etnike maqedonase, shqiptare dhe të tjera. Më saktë, pothuajse gjysa e nxënësve/eve të anketuar/a janë Maqedonas/e (48%), rreth dy të pestat janë Shqiptarë/e (42%), dhe 10% të mbetur janë nxënës/e të përkatësive të tjera etnike.

Më konkretisht, në shkollat “homogjene”, shpërndarja sipas përkatësisë etnike tregon se rreth 60% e nxënësve/eve janë maqedonas/e, rreth 33% janë shqiptarë/e, ndërsa pjesa tjetër 7% janë nga grupet tjera etnike. Nga ana tjetër, në shkollat “heterogjene”, struktura është më e ndryshme. Këtu nxënësit/et shqiptarë/e janë përfshirë në një numër pak më të madh se nxënësit/et maqedonas/e, edhe atë përkatësisht 48%: 40%. Në krahasim me vitet e kaluara (vitet 2011 dhe 2012), ekzistojnë dallime në qasjen ku nga gjithsej pesë shkollat në të cilat janë realizuar hulumtimet, në tre shkolla arsimohen nxënës/e nga të gjitha përkatësitë etnike në Maqedoni (maqedonas/e dhe dhe të tjerë + shqiptarë/e), ndërsa në dy shkollat e tjera ShMQSh Gjinnazi “Nikolla Karev” dhe ShMQSh Gjinnazi “Orce Nikolov” vetëm maqedonas/e dhe përkatësi të tjera.

Sipas përkatësisë etnike të nxënësve në shkollat “homogjene”, në hulumtimin nga viti 2011, janë anketuar 92% të nxënësve maqedonas dhe 8% e anëtarëve të përkatësive më të vogla etnike. Në hulumtimin e vitit 2012 nga përbërja nacionale janë përfshirë 96% maqedonas/e dhe 4% të përkatësive të tjera etnike. Në shkollat “heterogjene” në vitin 2011 janë përfshirë 42% të maqedonasve/eve, 49% shqiptarëve/eve dhe 9% të komuniteteve të tjera etnike, ndërsa në hulumtimin e vitit 2012 janë përfshirë 41% maqedonas/e, 51% shqiptarë/e dhe 8% të përfaqësuesve të komuniteteve më të vogla etnike.

Në hulumtimin e parë në vitin 2011 (370 nxënës), janë anketuar 179 nxënës dhe 191 nxënëse. Nga numri i përgjithshëm 230 janë maqedonas/e, 109 janë shqiptarë/e dhe 31 janë të përkatësive tjera etnike (11 serbë/e, 4 turq/turke, 4 romë/e, 1 vllleh/e, 7 boshnjakë/e, 2 kroat/e, 2 nuk e kanë treguar përkatësinë e tyre etnike). 302 nga nxënësit/et e anketuar jetojnë në mjedis urban, 65 në mjedis rural dhe 3 kanë refuzuar të tregojnë.



Në hulumtimin e dytë në vitin 2012 (325 nxënës/e) sipas shpërndarjes gjinore 153 janë meshkuj dhe 172 nxënës femra. Nga numri i përgjithshëm i nxënësve/eve të anketuar, 209 janë maqedonas/e, 95 janë shqiptarë/e dhe 21 janë të përkatësive tjera etnike (8 serbë/e, 1 turk/e, 3 romë/e, 1 vlleh/e, 6 boshnjakë/e, 2 kroat/e). Sipas vendbanimit, 271 nga nxënësit/et e anketuar jetojnë në mjedis urban, 52 në mjedis rural dhe 2 kanë refuzuar të tregojnë.

Hulumtimi i tretë i realizuar në vitin 2019 (në 400 nxënës/e), tregon se 38% janë nxënës, 60% janë nxënës ndërsa 2% janë deklaruar në kategorinë “tjetër”. Nga të gjithë nxënësit/et e anketuar, 191 janë maqedonas/e, 167 janë shqiptarë/e dhe 42 janë nga përkatësitë tjera etnike (4 nga përkatësia serbe, 22 turke, 9 rome, 1 vllehe, 5 boshnjake, dhe 1 nga përkatësia etnike malazeze). 70% prej këtyre nxënësve/eve jetojnë në qytete ndërsa 30% janë nga mjediset rurale.

Analiza e profilit sociologjiko-demografik të nxënësve/eve të anketuar në këta shkolla të mesme tregon se ka dallime të mëdha sipas vendbanimit, përkatësisë etnike të nxënësve/eve dhe strukturës gjinore.

Radiusi i observimit të fenomeneve të dhunës në shkollat e mesme është zgjerruar dhe janë përfshirë gjashtë shkolla jashtë Shkupit. Me dizajnim të këtillë mostrës kishim për ide të bëjmë një mostër e cila në një masë më të madhe do të jetë më e afërt me universumin<sup>4)</sup> e përgjithshëm të nxënësve/eve në shkollat e mesme. Kjo paraqet përpjekje të shikojmë se në cilën shkallë dhe në cilat pika janë rezultatet e përafërta, ndërsa në cilën shkallë dallojnë. Në tabelën 2 janë paraqitur shkollat sipas asaj se a janë “heterogjene” (sh-heterogjene) ose “homogjene”. Sipas tabelës 2, struktura sociodemografike nëpër vite është e afërt dhe mundëson bazë të mirë për krahasim, por nga ana tjetër duhet pasur parasysh se bëhet fjalë për shkolla të ndryshme për krahasim, dhe për këtë shkak hulumtimet në vitet 2011 dhe 2012 krahasimet e rezultateve do t'i marrim si ilustrim.

**Tabela 2**

Shkolla (Shkollat M+/ Shq, M+ dhe Shq)	2011		2012		2019	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Shkolla M+ (Maqedonas dhe tjerë)/ shkolla A (vetëm Shqiptarë)	148	40	139	43	158	40
Shkolla (M+ dhe Shqiptarë)	222	60	186	57	242	60
Gjithsej	370	100%	325	100%	400	100%

Profesorët/eshat nga të njëjtat shkolla të mesme u përgjigjën në të njëjtën mënyrë duke i vetëplotësuar pyetësorët, por ata kryesisht i analizuan nxënësit/et dhe problemet me të cilat ballafaqohen ata në lidhje me ngjarjet në shkollat dhe ndikimin e Arsimit paqësor. Një pjesë e pyetjeve përputhen me pyetjet të cilave u janë përgjigjur nxënësit/et, ndërsa një pjesë më pak ose aspak. Struktura socio-demografike e profesorëve/eshave tregon se nga gjithsej 87 profesorë/esha të anketuar/a, 46 janë maqedonas/e dhe 32 janë shqiptarë/e. Profesorët/eshat e bashkësive të tjera etnike janë më pak, edhe atë serbët/et janë 2, turqit/turket 4 ndërsa vetëm një rom/e. Nga aspekti i homogjenitetit të shkollave, profesorët/eshat janë në përqindje më e vogël prej shkollave homogjene, rreth 40% prej tyre, dhe rreth 60% prej shkollave heterogjene. Pak më shumë se gjysma e profesorëve/eshave (55%) janë pjesë e Programit të arsimit paqësor të cilin e zbaton Megjashi, dhe 45% nuk janë të përfshirë në të.

**Tabela 3**

2019 Shkolla - profesorë/esha	A jeni Ju pjesë e Programit për arsim paqësor i cili zbatohet në shkollat në bashkëpunim me Ambasadën e parë të fëmijë në botë - Megjashi?					
	Po		Jo		Gjithsej	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
ShMQSh Gjmnazi “Nikolla Karev” Shkup	3	6	3	8	6	7
ShMQSh Gjmnazi “Orce Nikollov” Shkup	/	/				
ShMMQSh “Dr. Pançe Karagjov” Shkup	/	/				
ShMQSh “Arseni Jovkov” Shkup	4	9	5	13	9	11
ShMNQSh “Zdravko Cvetkovski” Shkup	/	/				
ShMQSh Gjmnazi “Zef Lush Marku” Shkup	7	15	2	5	9	11
ShMK “28 Nëntori” Dibër	8	17	6	16	14	16
ShMK Gjmnazi “Gostivari” Gostivar	3	6	4	11	7	8
ShMEK Gostivar - Shkolla Ekonomike	5	11	6	16	11	13
ShMPK “Dimitrija Çupovski” - Veles	3	6	3	8	6	7
ShMK “Gjmnazi Koço Racin” - Veles	8	17	7	18	15	18
ShMK “Vanço Përke” - Vinicë	6	13	2	5	8	9
Gjithsej	47	100%	38	100%	85 <sup>5)</sup>	100%


<sup>5)</sup> Dy profesorë/esha nuk janë përgjigjur në cilën shkollë punojnë / a janë pjesë e Arsimit paqësor

### 3. Pasqyra e përgjithshme për perceptimin e klimës së përgjithshme të marrëdhënieve në mes nxënësve/eve në shkollat e mesme

*Komunikimi në mes nxënësve/eve nga grupe të ndryshme etnike dhe komunikimi në mes profesorëve/eshave nga grupet e ndryshme etnike (2011 – 2019)<sup>6)</sup>*

a) Frekuenca e komunikimit

Grafiku 1



Faktor bazik i cili është i lidhur në mënyrë të pandashme me dhunën dhe klimën e përgjithshme në marrëdhëniet mes nxënësve/eve të shkollave të mesme është komunikimi i tyre i ndërsjellë. Në çfarë mënyrë është zhvilluar, dhe a ekziston komunikim ndërmjet etniteteve të ndryshme, respektivisht sa frekuenca e komunikimit është me karakter pozitiv dhe ndikon në formimin e një klime më të favorshme në shkolla.

Hulumtimi i fundit tregon se pothuajse 41% e nxënësve/eve komunikojnë shpesh me me nxënës/e nga komunitete të tjera etnike, komunikimi (përgjigje “ndonjëherë”) më i rrallë është tek 34% prej nxënësve/eve, ndërsa rreth 21% prej nxënësve/eve komunikojnë rrallë. Vetëm 4% e nxënësve/eve nuk kanë komunikuar asnjëherë me nxënës/e të grupeve të tjera etnike. Shikuar përmes prizmit të komunikimit dhe bashkëjetesës së nxënësve/eve, mund të përcaktojmë shkallë të lartë të ndërlidhjes së përgjigjeve të atyre nxënësve/eve, të cilët pozitivisht (“mirë<sup>7)</sup>”) e vlerësojnë bashkëjetesën me ata me të cilët kanë edhe komunikim më të shpeshtë me nxënës/e të përkthësive tjera etnike. Proporcionalisht me këtë, nxënësit/et të cilët komunikojnë shpesh e vlerësojnë bashkëjetesën si “e mirë” janë 76%, “as mirë dhe as keq” vlerësojnë 20%, ndërsa “keq” vlerësojnë rreth 4% prej tyre. Nga ana tjetër, prej atyre të cilët “ndonjëherë” komunikojnë me nxënës/e nga komunitete të tjera etnike, 63% mendojnë se bashkëjetesa është “e mirë”, 30% se nuk është “as e mirë as e keqe” dhe 7% se është e keqe, ndërsa më të pakënaqur janë ata të cilët rrallë komunikojnë, 47% mendojnë se kanë bashkëjetesë të “”, 41% nuk kanë “as të mirë dhe as të keq”, ndërsa 12% kanë “të keq”. Prej 16 nxënës/eve të cilët nuk kane asnjëfarë komunikimi me nxënës/e të grupeve tjera etnike, 8 kanë deklaruar se kanë bashkëjetesë “të mirë”, 5 nuk kanë “as të mirë as të keqe”, ndërsa 3 kanë “bashkëjetesë

të keqe”<sup>8)</sup>. Prej të njëjtive, 14 nxënës/e janë të gatshëm për të komunikuar përdërisa vetëm 2 nuk janë të gatshëm të komunikojnë me nxënës/e të grupeve tjera etnike. Kur do t'i krahasojmë hulumtimet ndër vite vërejmë rritjen e tendencës për tu hapur ndaj komunikimit me nxënës/e të komuniteteve tjera etnike tek ata të cilët nuk kanë pasur komunikim paraprak.

Nga ana tjetër, me rritjen e shpeshtësisë së komunikimit, rritet edhe gadishmëria për të komunikuar. Kështu, ata që shpesh ose ndonjëherë komunikojnë me nxënës/e nga grupe të tjera etnike janë pothuajse plotësisht të gatshëm për komunikim të mëtutjeshëm (në vitin 2019 vetëm 4 nxënës/e që ndonjëherë komunikojnë nuk janë të gatshëm të komunikojnë me nxënës/e nga grupe të tjera etnike), ndërsa ata që rrallë komunikojnë me nxënës/e nga grupe të tjera etnike tregojnë gadishmëri pak më të ulët për komunikim (12 nxënës/e nuk janë të gatshëm për të komunikuar).


Prej rezultateve të anketave të cilat i kanë plotësuar profesorët/eshat në lidhje me atë se sa shpesh komunikojnë me profesorë/esha nga grupe të tjera etnike, pjesa më e madhe e tyre 72% shprehen që shpesh komunikojnë, 13% që ndonjëherë komunikojnë, rrallë 5% ndërsa 8% e profesorëve/eshave thonë se nuk ka profesorë/esha në shkollat e tyre të cilët janë nga komunitete të tjera etnike. Komunikimi në mes profesorëve/eshave në shkollat heterogjene është dukshëm më i shpeshtë, se sa mes profesorëve/eshave në shkollat homogjene edhe atë në shkollat heterogjene 80% e profesorëve/eshave komunikojnë “shpesh” në shkolla heterogjene, “ndonjëherë” rreth 18%, ndërsa “rrallë” vetëm 2%. Siç është përmendur tashmë, është e zvogluar frekuenca e komunikimit në mes profesorëve/eshave në shkollat homogjene edhe atë: 60% komunikojnë “shpesh”, “ndonjëherë” 3%, “rrallë” 10%, dhe nuk ka profesorë/esha nga grupe të tjera etnike në 27% të përgjigjeve të dhëna. Bashkëjetesa e profesorëve/eshave është kryesisht e lidhur me shpeshtësinë e komunikimit, siç është rasti me nxënësit/et. Rrjedhimisht, nga të gjithë profesorët/eshat të cilët kanë deklaruar se shpesh komunikojnë me profesorë/esha nga grupe të tjera etnike, 94% mendojnë se kanë bashkëjetesë të mirë, 6% se nuk kanë as të mirë e as të keqe, dhe asnjë profesor/eshë nuk është deklaruar se ka bashkëjetesë të keqe me profesorë/esha të grupeve të tjera etnike. Ata profesorë/esha të cilët ndonjëherë komunikojnë me profesorë/esha të grupeve të tjera etnike, 82% kanë bashkëjetesë të mirë ndërsa 18% nuk kanë as bashkëjetesë të mirë e as të keqe. Nga vetëm 4 profesorë/esha të cilët janë deklaruar se rrallë komunikojnë me profesorë/esha nga grupe të tjera etnike, të gjithë kanë bashkëjetesë të mirë me profesorët/eshat tjerë.

Krahasimi i të dhënave për frekuencën e komunikimit të nxënësve/eve të përkatësive të ndryshme etnike dhe vlerësimin e kualitetit së bashkëjetesës të fituara nga hulumtimet në vitet 2011 dhe 2012 pa mëdyshje tregojnë se janë të lidhura në një mënyrë identike si në hulumtimin nga viti 2019. Në hulumtimet e mëparshme poashtu konstatoam se sa më i shpeshtë është komunikimi, aq më i madh është kontributi i tij në krijimin e një klime përgjithësisht më të favorshme në marrëdhëniet në mes nxënësve të shkollave të mesme.

### *b) Vendi i komunikimit në mes nxënësve/eve të grupeve të ndryshme etnike*

Nga përgjigjet e të gjithë nxënësve/eve të anketuar, në të gjitha shkollat e përfshira me tre hulumtimet, rrjedh se në numrin më të madh të rasteve nxënësit/et komunikojnë në shkolla (2011- 70%; 2012- 73%, 2019- 70%).

**Grafiku 2**



Vendet për komunikim ndryshojnë në mënyrë të parëndësishme ndër vite dhe kryesisht mbeten të njëjtat vende kryesore ku komunikojnë nxënësit/et. Në vitin 2019 përveç shkollave, në vendin e dytë gjenden vendet e argëtimit, pastaj lagja, pastaj fushat sportive, etj. Vërehet një trend i rënies në komunikimin e nxënësve/eve nga grupe tjera etnike në lagje, nga 37% në 2011 në 34% në 2012 dhe në 26% në 2019 që ka të bëjë me dallimet strukturore në mostrat e hulumtimit nga vitet 2011 - 2012 dhe hulumtimi i vitit 2019. Përkatësisht, nëse kryqëzohen të dhënat e kësaj pyetjeje me variablin shkollat në Shkup dhe shkollat jashtë Shkupit kjo tregon se 34% e nxënësve/eve nga Shkupi shoqërohen me nxënës nga grupe të tjera etnike, ndryshe nga nxënësit në shkollat e mesme jashtë Shkupit, 22% shoqërohen me nxënësit/et në lagje nga grup tjetër etnik.


Vërehet një variacion i rezultateve me tendencë të zvogëlimit të numrit të vendeve për komunikim ndër vite, në krahasim nëse analizohen vetëm shkollat në Shkup. Në përgjigjet e komunikimit, ka një ndryshim ndër vite në vetëm një vend edhe atë nga 47% në 2011, 40% në 2012 në 58% nga hulumtimi i rezultateve në vitin 2019. Të dhënat tregojnë se nxënësit/et nga Shkupi (58%) komunikojnë më shpesh në një vend se sa nxënësit/et të cilët jetojnë në qytete të tjera (48%). Por nëse i shikojmë rezultatet e mostrës totale nga viti 2019, kryesisht më së shumti komunikohet në një vend (më së shpeshti komunikimi është në shkollat) tek 52% të nxënësve/eve, 25% komunikojnë në dy vende ndërsa 23% në tre ose më shumë vende.

***Vlerësimi i kapaciteteve të gjithëpërfshirjes së nxënësve/eve të shkollave të mesme (2011 - 2019)***

Grupi tjetër i pyetjeve të cilat parashtrohen gjatë viteve ka të bëjë me potencialin e pranimit të lidhjeve të ngushta me anëtarët e grupeve të tjera etnike. Në analizën e më tutjeshme, termi “gjithëpërfshirje” paraqet gadishmëri për të pranuar lidhje të ngushta me anëtarët e grupeve të ndryshme etnike, përballë një mosgadishmërisë për të pranuar lidhje të ngushta - “ekskluzivitet”.

Përgjigjet e pyetjeje “A do të pranoni dashnor ose dashnore të ndonjë shokut/ shoqes tuaj të ngushtë ose të dikujt nga farefisi juaj j të jetë nga një grupi tjetër etnik?” në të tre hulumtimet tregojnë një nivel të vazhdueshëm të gatishmërisë për të pranuar marrëdhënie të ngushta me anëtarët e grupeve të ndryshme etnike. Përkatësisht, prej 45% të përgjigjeve nga nxënësit/et të cilët shprehën gatishmërinë për të pranuar në vitin 2011, në anketën nga viti 2012 e njëjta përqindje e nxënësve/eve të gatshëm për të pranuar (tregues të gjithëpërfshirjes) lidhje të ngushta me anëtarët e grupeve të ndryshme etnike është 47%, madje përqindje më të larta janë marrë me anketën e vitit 2019, ku 53% tregojnë përfshirje të një dashnori/dashnoreje nga një i afërt, të jetë nga një grup tjetër etnik.

**Grafiku 3**



Ndër vite vërehet një tendencë për të ulur jotolerancën respektivisht të rritet gjithëpërfshirja sa i përket shkollave të llojit homogjen dhe heterogjen. Më saktë, një rënie e lehtë e gjithëpërfshirjes është vërejtur në shkollat me përbërje socio-demografike homogjene nga 61% në 2011/2012<sup>9)</sup> në 55% pikë përqindje në vitin 2019. Ndërsa rritje e caktuar e gjithëpërfshirjes është vërejtur tek shkollat e llojit heterogjen socio-demografik, ku rritja e gjithëpërfshirjes nga 2012 në 2019 është me 14% pikë përqindje (51% në 2019 kundrejt 37% në 2012, Tabela 4).

**Tabela 4**

"A do të kishit pranuar dashnor ose dashnore të ndonjë shokut/shoqes tuaj të ngushtë ose të farefisit tuaj t'i takojë një grupi tjetër etnik?"		Shkolla (Shkollat M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkolla M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (shkolla vetëm Shqiptarë)		Shkolla (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	%
		Numri	%	Numri	%		
2011	Po	90	61%	77	35%	167	45%
	Jo	58	39%	145	65%	203	55%
	Gjithsej	148	100%	222	100%	370	100%
2012	Po	85	61%	69	37%	154	47%
	Jo	54	39%	117	63%	171	53%
	Gjithsej	139	100%	186	100%	325	100%
2019	Po	87	55%	123	51%	210	53%
	Jo	71	45%	119	49%	190	47%
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%

*a) Analizë e kapaciteteve të dimensionit gjithëpërfshirje – ekskluzivitet sipas përkatësisë etnike*

Shikuar përmes prizmes së përkatësisë etnike në aspektin e dimensionit të gjithëpërfshirjes ose ekskluzivitetit, analiza e rezultateve të hulumtimit tregon se ekzistojnë dallime në mes maqedonasve/eve, shqiptarëve/eve dhe anëtarëve të komuniteteve më të vogla etnike në këtë drejtim.

Tek anëtarët e përkatësisë etnike shqiptare, gjithëpërfshirja - ekskluziviteti mbetet e pandryshuar në krahasim me vitin 2012 me rezultatet e fundit të fituara në vitin 2019. Respektivisht, dallime ekzistojnë në

krahasim me vitin 2011 ku gjithëpërfshirja është dukshëm më pak e përhapur (28% në 2012) në proporcion me 2.6 herë më të përhapur në qendrim ekskluziv (72% në 2011). Tek maqedonasit/et, këto ndryshime janë vërejtur në krahasim me vitin 2019 ku nga matja e fundit në vitin 2012, rritja e gjithëpërfshirjes është 11% pikë përqindje në vitin 2019 për këtë pyetje (49% në 2012 kundrejt 60% në 2019). Proporcionalisht me këtë, nga ana tjetër, ekskluziviteti tek maqedonasit/et është në zvogëlim. Rezultatet janë më variable tek anëtarët e grupeve të tjera etnike për shkak të mostrave të vogla, por rezultatet tregojnë një tendencë për gjithëpërfshirje të shtuar në ndaj vitit 2012 në krahasim me vitin 2019. (2011- 68%, 2012- 57% dhe 2019 - 71%).

**Tabela 5**

		A do të kishit pranuar dashnor ose dashnore të ndonjë shokut/shoqestuaj të ngushtë ose të farefisit tuaj t'i takojë një grupi tjetër etnik?				Gjithsej	
		PO		JO		N	% në rregull
		N	% në rregull	N	% në rregull		
2011	Maqedonas/e	115	50%	115	50%	230	100%
	Shqiptar/e	31	28%	78	72%	109	100%
	Nacionalitet tjetër	21	68%	10	32%	31	100%
	Gjithsej	167	45%	203	55%	370	100%
2012	Maqedonas/e	103	49%	106	51%	209	100%
	Shqiptar/e	39	41%	56	59%	95	100%
	Nacionalitet tjetër	12	57%	9	43%	21	100%
	Gjithsej	154	47%	171	53%	325	100%
2019	Maqedonas/e	114	60%	77	40%	191	100%
	Shqiptar/e	66	40%	101	60%	167	100%
	Nacionalitet tjetër	30	71%	12	29%	42	100%
	Gjithsej	210	52%	190	48%	400	100%

**b) Tipologjia e qëndrimit emocional ndaj etnikumeve dhe lidhja e tyre me dimensionin gjithëpërfshirës - ekskluzivitetin midis nxënësve të shkollave të mesme**

Me ndihmën e grupit të pyetjeve të cilat kanë të bëjnë me ndjenjat ndaj grupeve të caktuara etnike, ne i shqyrtojmë preferencat etnike bazuar në ndjenja pozitive, të matura dhe negative. Pyetjet kanë të bëjnë me vlerësimin e secilit grup etnik në një shkallë pesë-hapëshe e cila shtrihet nga ndjenja shumë pozitive deri te ato shumë negative për një grup të caktuar etnik. Përpunimi i të dhënave bazohet në grumbullimin e përgjigjeve të të anketuarve dhe në bazë të të dhënave të grumbulluara ashtu, bëhet tipologjia e qëndrimit të përgjithshëm emocional ndaj anëtarëve të grupeve etnike. Kjo tipologji përfshin 3 nivele të qëndrimit të përgjithshëm emocional ndaj pjesëtarëve të bashkësive etnike::

- dominimi i ndjenjave negative ndaj anëtarëve të etnikumeve tjera
- emocione të matura ose të përziara ndaj anëtarëve të etnikumeve tjera
- dominimi i ndjenjave pozitive ndaj anëtarëve të etnikumeve tjera

Vija e forcimit të raportit në mes gjithëpërfshirjes dhe dominimit të ndjenjave pozitive është e dukshme ndër vite. Respektivisht edhe përkundër variacioneve ndërmjet viteve, ndjenjat pozitive dominojnë në vitin 2019 në aspektin e gjithëpërfshirjes dhe kështu 60% e nxënësve/eve janë shprehur se do të praninin një dashnor ose dashnore e një personi të afërt dhe gjithashtu tregojnë ndjenja pozitive ndaj grupet tjera etnike. Këto përqindje janë më të ulëta në vitet 2011 dhe 2012 ku përkatësisht të njëjtat shprehen me 42% dhe 33%. Në fakt, edhe pse me variacione të caktuara, vërehet një zhvendosje e intensitetit të ndjenjave nga emocione të matura në ndjenja pozitive ndër vite tek nxënësit/et nga grupe të ndryshme etnike me qëndrim gjithëpërfshirës. Ndjenjat e matura të përfaqësuara në përqindje shkonin nga 49% në 2011, 62% në 2012 dhe 36% në 2019. Dominimi i ndjenjave negative ndaj nxënësve/eve nga grupe të tjera etnike në mesin e nxënësve/eve

me një qëndrim gjithëpërfshirës janë në rënie të lehtë ndër vite, dhe kështu që në vitin 2011, nga 9%, në 2012 në 5% që në 2019 përqindja të shënon rënie në 3%.

Ndërkohë, ndjenjat e matura tek nxënësit/et me qëndrim ekskluziv ndër vite shënon ulje të lehtë, prej 63% në 2011, në 61% në 2012 dhe deri në 56% në vitin 2019. Tek të njëjtët nxënës/e, dominimi i qëndrimit negativ dhe pozitiv mbetet pothuajse i pandryshuar. Dhe kështu, dominimi i ndjenjave negative tek nxënësit/et me qëndrim ekskluziv është prej 15% në 2011, 11% në 2012 në 17% në 2019 ndërsa dominimi i ndjenjave pozitive tek të njëjtët është prej 23% në 2011, 28% në 2012 në 27% në vitin 2019 (shiko Tabelën 6).

**Tabela 6**

		A do të kishit pranuar dashnor ose dashnore të ndonjë shokut ose shoqes tuaj të ngushtë ose të farefisit tuaj t'i takojë një grupi tjetër etnik?				Gjithsej	
		PO		JO		N	%
		N	%	N	%		
2011	Dominim i ndjenjave negative	14	9%	28	15%	42	12%
	Intensitet i matur i ndjenjave	79	49%	119	63%	198	56%
	Dominim i ndjenjave pozitive	68	42%	43	23%	111	32%
	Gjithsej	161	100%	190	100%	351	100%
2012	Dominim i ndjenjave negative	8	5%	19	11%	27	9%
	Intensitet i matur i ndjenjave	94	62%	101	61%	195	61%
	Dominim i ndjenjave pozitive	50	33%	47	28%	97	30%
	Gjithsej	152	100%	167	100%	319	100%
2019	Dominim i ndjenjave negative	7	3%	32	17%	39	10%
	Intensitet i matur i ndjenjave	76	36%	107	56%	183	46%
	Dominim i ndjenjave pozitive	127	60%	51	27%	178	44%
	Gjithsej	210	100%	190	100%	400	100,0%

Këto shabllone aksiono-emocionale të reagimeve tipike ndaj anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike formojnë aspekte psikologjike të personit që në situata të ndryshme jetësore në mënyrë të paditur dhe automatikisht dalin në pah. Për këtë shkak kur kërkohen shkaqet e problemeve të cilat ndodhin në mjedise të përziera etnike fillimisht duhet pasur kujdes ndaj komponentëve emotivo-iracionale të cilat i përcaktojnë reagimet e njerëzve, ndërsa mos të merren parasysh vetëm determinatët racional-objektiv të cilët e përcaktojnë sjelljen e njerëzve në mjedise multietnike. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse këto komponenta emotivo-vepruese janë lehtë “të ndezshme” tek më të rinjtë. Ky gjeneralizim i lidhjes, llojit emocional të vijës së dimensionit inkluzivitet - ekskluzivitet që vendosëm bazuar në rezultatet e hulumtimit të viteve 2011 - 2012, në hulumtimin e vitit 2019 variacionet lëvizin në drejtim të forcimit të këtyre lidhjeve dhe veç të tjerash, paraqet një kontribut pozitiv të ndikimit të Arsimit paqësor në krijimin e një klime pozitive psikologjike dhe sociale në marrëdhëniet në mes nxënësve/eve në shkollat e mesme.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet qëndrimeve në lidhje me arsyetimin ose mosarsyetimin e përdorimit të dhunës gjatë zgjidhjes së problemeve në shoqëri. Të dhënat janë veçanërisht brengosëse sepse në mesin e nxënësve/eve tek të cilët dominojnë ndjenjat pozitive ndaj grupeve të tjera etnike, vërehet një trend i rritjes së numrit të nxënësve/eve të cilët e konsiderojnë të arsyeshme përdorimin e dhunës (e arsyeshme 2011 - 17%, 2012 - 11%, 2019 - 21%). Një konstatim i tillë, jep bazë për të supozuar se kjo gjendje duhet lidhur me ndikimet negative të tendencave politiko-shoqërore të cilat “zbrazen” nëpër shkolla. Ky trend është akoma më i theksuar në mesin e nxënësve/eve tek të cilët kanë dominuar ndjenjat negative. Mes tyre, arsyetimi për përdorimin e dhunës rritet në mënyrë lineare, nga 36% në 2011, në 44% në 2012 në 49% në vitin 2019 (shiko Tabelën 7).

Thënë shkurt, mund të konstatohet se tendencat e pafavorshme shoqërore masive-psikologjike kanë një efekt negativ më të madh sesa arritjet përsa i përket përfitimeve të arritura në kuadër të Arsimit paqësor. Prandaj duhet të theksojmë se në mungesë të një trendi stabil dhe afatgjatë të përmirësimit të klimës sociale në vend në tërësi, arritjet pozitive në kuadër të Arsimit paqësor do të jenë të kufizuara.



**Tabela 7**

	Tipologjia e ndjenjave emotive ndaj grupeve tjera etnike	A konsideron se përdorimi i dhunës për zgjidhjen e problemeve në shoqëri është e arsyeshme ose epa arsyeshme					
		E arsyeshme		Nuk është e arsyeshme		Gjithsej	
		N	%	N	%	N	%
2011	Dominim i ndjenjave negative	15	36%	27	64%	42	100%
	Intensitet i matur i ndjenjave	52	26%	146	74%	198	100%
	Dominim i ndjenjave pozitive	19	17%	92	83%	111	100%
	Gjithsej	86	24%	265	76%	351	100%
2012	Dominim i ndjenjave negative	12	44%	15	56%	27	100%
	Intensitet i matur i ndjenjave	41	21%	154	79%	195	100%
	Dominim i ndjenjave pozitive	11	11%	86	89%	97	100%
	Gjithsej	64	20%	255	80%	319	100%
2019	Dominim i ndjenjave negative	19	49%	20	51%	39	100%
	Intensitet i matur i ndjenjave	60	33%	123	67%	183	100%
	Dominim i ndjenjave pozitive	37	21%	141	79%	178	100%
	Gjithsej	116	29%	284	71%	400	100%

Në përpunimin e të dhënave nga hulumtimet prej viteve 2011 dhe 2012, për tipologjinë e ndjenjave emotive, nuk janë marrë parasysh 25 raste nga të dyja valët të cilët nuk kanë dhënë përgjigje se çfarë ndjenja kanë ndaj të gjitha 6 nacionaliteteve të përmendura.

## 4. Klima ndëretnike në shkolla (2011- 2019)

*Perceptimi i tensioneve dhe incidenteve<sup>10)</sup> dhe format e dhunës në shkollat e mesme*

*Perceptimi i tensioneve dhe incidenteve nga ana e nxënësve/eve*

Perceptimet për tensionet ndëretnike ose incidente në shkollat janë matur në mënyrë që nxënësit/et e theksojnë ekzistimin e të njëjtave duke i dalluar tensionet veçmas prej incidenteve. Të dhënat nga hulumtimi i vitit 2019 tregojnë se në pothuajse përqindje të njëjta janë prezente incidentet dhe tensionet ndëretnike në shkollë, edhe atë tensionet janë prezente në 55% prej përgjigjeve, ndërsa vetëm për 4 përqind më pak janë të theksuara incidentet (51%). Domethënë, pothuajse çdo i dyti nxënës/e haset me tensione ose incidente të caktuara në shkollën në të cilën mëson.

Gjatë kryqëzimit të rezultateve në lidhje me incidentet dhe tensionet në shkollat, pak më shumë se një e treta e nxënësve/eve (36%) thonë se tensione dhe incidente të tilla ekzistojnë në shkollë, më pak se një e treta (30%) se nuk ka tensione apo incidente, ndërsa ekzistojnë vetëm tensione tek 19% dhe se ka vetëm incidente tek 15% në shkollave (shiko Tabelën 8).

**Tabela 8**

2019		A konsideron se ka ose nuk ka tensione ndëretnike në shkollën tënde?					
		Po, ka		Jo, nuk ka		Gjithsej	
		Numri	Gjithsej %	Numri	Gjithsej %	Numri	Gjithsej %
A konsideron se ka ose nuk ka tensione ndëretnike në shkollën tënde?	Po	144	36	76	19	220	55
	Jo	59	15	121	30	180	45
	Gjithsej	203	51	197	49	400	100

Në krahasim me vitet e kaluara këto përqindje ndryshojnë ndërsa fotografia e përgjithshme tregon se numri i tensioneve dhe incidenteve po rritet në hulumtimin e vitit 2019. Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se ka një ndjenjë të rritur pozitive ndaj anëtarëve të komuniteteve të tjera etnike pa dallim nga fakti që tensionet dhe incidentet po rriten, që do të thotë se këto probleme mund të shkaktohen nga një grup i caktuar individësh. Kështu, në shkollat në të cilat ka pasur tensione, prej 48% në vitin 2011 përqindja zvogëlohet në 36% në vitin 2012 dhe përsëri rritet në vitin 2019 në 55%. Trendi i njëjtë vërehet edhe me paraqitjen e incidentëve, ku në vitin 2011, 46% janë shprehur se ka pasur incidente ndëretnike, dhe në vitin 2012 kjo përqindje zvogëlohet në 40% që në vitin 2019 përsëri të arrijë në akoma rritje më të lartë të tensioneve në 51% (shiko Tabelën 9).

**Tabela 9**

	A konsideron se ka ose nuk ka tensione / incidente ndëretnike në shkollën tënde?	Tensione ndëretnike		Incidente ndëretnike	
		N	%	N	%
<b>2011</b>	Po, ka	178	48%	170	46%
	Jo, Nuk ka	185	50%	193	52%
	Refuzon të përgjigjet / pa përgjigje	7	2%	7	2%
	Gjithsej	370	100%	370	100%
<b>2012</b>	Po, ka	117	36%	131	40%
	Jo, Nuk ka	202	62%	194	60%
	Refuzon të përgjigjet / pa përgjigje	6	2%	0	0%
	Gjithsej	325	100	325	100
<b>2019</b>	Po, ka	220	55%	203	51%
	Jo, Nuk ka	180	45%	197	49%
	Refuzon të përgjigjet / pa përgjigje	400	100%	400	100%

Për shkak se mostra nga viti 2019 përfshin shkolla në Shkup dhe jashtë Shkupit, të dhënat nga ky hulumtim i kryqëzuar me variablin shkollat në Shkup dhe jashtë Shkupit<sup>11</sup>. Krahasimi i të dhënave nga shkollat që janë nga Shkupi në këtë plan në të tre hulumtimet lëvizin në kornizat në të cilat edhe tensionet edhe incidentet janë më pak të pranishme, ndërsa në numër të madh janë ata që shprehen se nuk janë të pranishëm (2011 ka tensione / pa tensione - 48% / 50%, 2012 - 36% / 62%, 2019 - 44% / 56%) e ngjashme është struktura për sa i përket perceptimit të pranisë / mungesës së incidenteve ndëretnike (2011 ka incidente / pa incidente 46% / 52%, 2012 - 40% / 60%, 2019 - 44% / 56%). Kjo do të thotë se në këtë periudhë prej 8 vitesh prap se prap mbahet struktura e perceptimit të numrit të nxënësve/eve të cilët në një numër më të vogël deklarojnë se ka tensione apo incidente në krahasim me shumicën e nxënësve/eve të cilët deklarojnë se nuk ka tensione apo incidente. Për dallim prej kësaj në shkollat jashtë Shkupit, nxënësit/et në ato shkolla deklarojnë se në numër më të madh janë prezente edhe tensionet (62% ka 38% nuk ka) dhe incidentet (55% ka 45% nuk ka) (Shih Tabelat 10 dhe 11). Për shkak se nuk kemi të dhëna krahasuese për këto parametra nga vitet e kaluara në këtë situatë mund të themi vetëm se në nivelin e mostrës totale “kontributi” i rritjes së numrit të perceptimeve në mes nxënësve/eve nga shkollat jashtë Shkupit është domethënës në kahje të dominimit të pranisë edhe të tensioneve edhe incidenteve se ndaj mungesës së tyre. Kjo do të thotë që klima e përgjithshme për sa i përket marrëdhënieve ndëretnike është më pavolitshme në shkollat jashtë Shkupit se sa në shkollat në Shkup.

**Tabela 10**

<b>2019</b>		Shkolla në Shk dhe shkolla jashtë Shk				Gjithsej	
		1 Shkolla në Shkup		2 Shkolla jashtë Shkupit		N	Kol %
		N	Kol %	N	Kol %		
Q8_1. A konsideron se ka ose nuk ka tensione ndëretnike në shkollën tënde?	1 Po, ka	68	44%	152	62%	220	55%
	2 Jo, nuk ka	86	56%	94	38%	180	45%
Gjithsej		154	100.0%	246	100.0%	400	100.0%

**Tabela 11**

2019		Shkolla në Shk dhe shkolla jashtë Shk				Gjithsej	
		1 Shkolla në Shkup		1 Shkolla në Shkup		N	Kol %
		N	Kol %	N	Kol %		
Q8_2. A konsideron se ka ose nuk ka incidente ndëretnike në shkollën tënde?	1 Po, ka	67	44%	136	55%	203	51%
	2 Jo, nuk ka	87	56%	110	45%	197	49%
Gjithsej		154	100.0%	246	100.0%	400	100.0%

***Perceptimi i tensioneve dhe incidenteve nga ana e profesorëve/eshave (2019)***

Në lidhje me problemin me tensionet ndëretnike mund të vërejmë diçka paraqitje më të lartë të problemit me tensionet ndëretnike tek profesorët/eshat të cilët janë përfshirë në Arsimin paqësor (36%) në krahasim me profesorët/eshat që nuk janë të përfshirë në Arsimin paqësor (28%). Gjatë krahasimit në mes nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave, perceptimi i tensioneve ndëretnike është dukshëm më i ulët në mesin e profesorëve/eshave që deri diku tregojnë se nxënësit/et nuk bisedojnë/ndajnë mjaftueshëm me profesorët/eshat e tyre, pa dallim se a janë ose nuk janë ata pjesë e Arsimi paqësor. Ai besim dhe lidhje në mes nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave ka një rëndësi të madhe për kontrollin e situatës në shkolla. Të ngjashme janë perceptimet e profesorëve/eshave në lidhje me incidentet ndëretnike të cilëa tek nxënësit/et paraqiten me 51% ndërsa profesorët/eshat e përfshirë në Programin e arsimit paqësor i perceptojnë në 23% a ata që nuk janë të përfshirë në program i perceptojnë në 28 % (shih Tabelat 12 dhe 13).

**Tabela 12**

Përgjigjet e profesorëve/eshave 2019		A konsideron se ka ose nuk ka tensione ndëretnike në shkollën tënde?					
		Po, ka		Jo, nuk ka		Gjithsej	
		Numri	Kolona %	Numri	Kolona %	Numri	Kolona %
A jeni Ju pjesë e Programit për arsim paqësor i cili zbatohet në shkollat në bashkëpunim me Ambasadën e Parë për Fëmijë në Botë – Megjashi?	Po	17	36	30	64	47	100
	Jo	11	28	28	72	39	100
	Gjithsej	28	33	58	67	86	100

**Tabela 13**

Përgjigjet e profesorëve/eshave 2019		A konsideron se ka ose nuk ka incidente ndëretnike në shkollën tënde?					
		Po, ka		Jo, nuk ka		Gjithsej	
		Kolona %	Numri	Kolona %	Kolona %	Numri	Kolona %
A jeni Ju pjesë e projektit "Arsimi paqësor" i cili zbatohet në shkollat në bashkëpunim me Ambasadën e parë për fëmijë në botë – Megjashi?	Po	11	23	36	77	47	100
	Jo	11	28	28	72	39	100
	Gjithsej	22	26	64	74	86	100

**Perceptimi i autorëve të dhunës si anëtarë të një grupi tjetër etnik përmes prizmit të strukturës së shkollës (2019)**

Përqindja e autorëve të dhunës që i përkasin një grupi tjetër etnik në vitin 2019 është më e lartë në shkollat e llojit heterogjen (52%) se sa në shkollat e llojit homogjen (35%). Është interesant fakti se në përqindje shumë të ngjashme, tek shkollat e tipit homogjen (21%) ose heterogjen (17%) nuk paraqitet dhuna në përgjigjet e nxënësve/eve, gjë që tregon deri diku se dhuna nuk është e lidhur domosdoshmërisht me strukturën etnike të shkollave. (shiko Tabelën 14). \*E rëndësishme, këtu nuk mund të bëhet asnjë krahasim me vitet e kaluara për shkak të dallimeve në pyetësorët (pyetësorët kanë ndikim ndaj algoritmit të validizimit).

**Tabela 14**

A i takojnë autorët e veprave të dhunshme grupit tjetër etnik?		Shkolla (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkolla M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkolla (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Po	55	35%	125	52%	180	45%
	Jo	69	44%	75	31%	144	36%
	Nuk ka dhunë në shkollë	33	21%	40	17%	73	18%
	Nuk e di	1	1%	2	1%	3	1%
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%

Në shkollat në Shkup (42%), më pak detektohen autorët e dhunës nga grupet e tjera etnike se sa shkollat jashtë Shkupit (47%), edhe pse përqindja e autorëve të një grupi tjetër etnik në nivelin e mostrës totale nuk është e papërfillshme (45%). Përqindja e shkollave në Shkup ku nuk ka dhunë është gjithashtu pak më e ulët (16%) në krahasim me shkollat jashtë Shkupit ku nuk ka dhunë (20%), gjë që tregon se dhuna është pothuajse po aq e përhapur kudo (shiko Tabelën 15).

**Tabela 15**

A i takojnë autorët e veprave të dhunshme grupit tjetër etnik?		Shkolla jashtë dhe në Shkup				Gjithsej	
		Shkolla në Shkup		Shkolla jashtë Shkupit		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Po	64	42%	116	47%	180	45%
	Jo	64	42%	80	33%	144	36%
	Nuk ka dhunë në shkollë	25	16%	48	20%	73	18%
	Nuk e di	1	1%	2	1%	3	1%
	Gjithsej	154	100%	246	100%	400	100%

## **5. Dhuna adoleshente (në mes bashkëmoshatarëve) – bullingu dhe forma tjera të sjellsjes së dhunshme**

Dhuna e bashkëmoshatarëve (bullingu) në hulumtimin është definuar si formë e sjellsjes agresive tek fëmijët në moshë shkollore, që zgjat për një kohë të gjatë, përsëritet dhe drejtohet në kahjen e të njëjtit person ose persona dhe nënkupton fuqi të pabarabartë. Dhuna mund të ketë formën e bullingut fizik dhe / ose verbal, sajber bullingut (ngacmimit në internet i cili është gjithnjë e më i pranishëm në mediat sociale si një mënyrë dhune dhe për këtë arsye, rëndësia e tij po bëhet më e rëndësishme, në hulumtimet e ardhshme

paraqitet nevoja të hulumtohet më hollësisht në kuadër të shumë kategorive që do të japin një pasqyrë më të qartë të saj), por edhe më pak i njohur i ashtuquajtur i bullingu social ose përjashtimi. Karakteristikë e bullingut është sjellja e dhunshme që përsëritet ose që ka potencial të përsëritet ndërsa ngacmimi përfshin vepra të ndryshme siç janë kërcënimet, përhapja e thashethemeve, dhënia e nofkave, sulmi fizik ose verbal, përjashtimi i qëllimshëm i dikujt nga një grup, etj. Nxënësit/et në pjesën edukative të anketës u njohtuan me këtë definicion.

Për të formuar një pasqyrë më të plotë të formave të sjelljes së dhunshme në shkollat e mesme të përfshita me hulumtimin e nxënësve/eve në anketë, iu parashtrua një grup prej 22 pyetjeve në lidhje me format e ndryshme të sjelljes së dhunshme, respektivisht cilat forma të sjelljes të dhunshme dhe sa shpesh janë të pranishme në shkollën e tyre. Përpunimi i të dhënave na mundësoi të rendisim format e sjelljes së dhunshme me dy parametra. Së pari, sipas numrit të nxënësve/eve që kanë një formë të caktuar të sjelljes së dhunshme, ata vlerësojnë se ajo është e pranishme në shkollën e tyre dhe, së dyti, sa shpesh shfaqet<sup>12)</sup> ajo formë. Produkti i këtyre dy parametrave jep rejting-pikët për secilën formë të sjelljes së dhunshme. Shuma e përgjigjeve të ponderuara (pesha) për secilën formë të sjelljes së dhunshme na lejon të rangojmë të dhënat respektivisht të formojnë një listë rejtingu sipas shpeshësisë së paraqitjes dhe numrit të nxënësve/eve të cilët një formë të caktuar të sjelljes së dhunshme e kanë theksuar në përgjigjet e tyre.

Kemi bërë përpunim plotësues statistikor të 22 formave të ndryshme të bullingut. Të dhënat tregojnë se çdo nxënës/e i/e tretë i/e anketuar (33%) kanë deklaruar prej një deri në 7 forma të dhunës së bashkëmoshatarëve, mbi gjysma e deklaruar 8 deri në 14 forma 52%, dhe 15 deri në 22 forma të dhunës së bashkëmoshatarëve deklaruan 13% dhe vetëm 2% nuk raportuan ndonjë formë dhune. Sipas gjinisë, shumica e nxënësve raportuan 8 deri në 14 forma të dhunës (57%) ndërsa nxënësit raportuan një numër dukshëm më të ulët (44%). Për dallim prej kësaj, 38% të nxënësve theksojnë prej 1 deri në 7 forma të dhunës ndërsa 31% të nxënësve, gjithashtu 15% e nxënësve raportuan 15 deri në 21 ndërsa nxënëset 11%. Sipas kësaj ekziston një tendencë e përgjithshme që nxënëset të theksojnë më shumë forma të dhunës, mesatarisht 9.41 ndërsa nxënësit 8.91. Sipas vendit, nxënësit/et jashtë Shkupit në një numër të madh theksojnë një deri 7 forma - 35% ndërsa 30% nxënësit/et nga Shkupi. Forma të theksuara prej 8 deri në 14 janë pothuajse të barabarta me 51% në Shkup dhe 53% jashtë Shkupit. Dallimi më i madh është nga 15 në 21 forma, në Shkup janë deklaruar 19% ndërsa jashtë Shkupit 9%. Kjo do të thotë se bullingu në Shkup ndodh ose njihet në më shumë forma se sa në qytetet e tjera të vendit ku supozohet se më pak mund t'i identifikojnë format e ndryshme të dhunës.

Në numrin e formave të të theksuara të dhunës ndërmjet shkollave homogjene dhe heterogjene praktikisht nuk ka dallime.

**Tabela 16**

B1 (Q11_12). Sipas teje, sa shpesh format e mëposhtme të sjelljes së dhunshme janë të pranishme në shkollën tuaj? <b>2019</b>	Nr. i nxënësve/eve që kanë theksuar dhunë të caktuar	%	Rejtingu në bazë të përgj. Nga ana e të gjithë të pyeturve H=400	Lista e rejtingut
B1_9 Ofendime, përqeshje mes nxënësve/eve	352	88	2.76	1
B1_1 Shkatërrimi i inventarit shkollor	337	84	1.82	2
B1_15 Rrahje mes nxënësve/eve	328	82	1.7	3
B1_3 Ofendimi i nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave	267	67	1.58	4
B1_6 Ofendimi i profesorëve/eshave nga ana e nxënësve/eve	218	55	1.2	5
B1_16 Rrahje mes nxënësve/eve të përkatësive të ndryshme etnike	240	60	1.14	6
B1_18 Rrahje me nxënës/e nga shkolla tjera	224	56	1.07	7
B1_19 Izolimi	175	44	1.02	8
B1_12 Mbajtja e thikës nga ana e nxënësve/eve	164	41	0.95	9
B1_4 Frikësim, kërcënim ndaj nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave	166	42	0.94	10
B1_11 Vjedhja e sendeve personale	184	46	0.89	11
B1_21 SMS porosi me përmbajtje të pakëndshme	160	40	0.86	12
B1_8 Frikësim, kërcënim nga persona tjerë të jashtëm	157	39	0.82	13
B1_20 Prekja e trupit në mënyrë të pakëndshme	140	35	0.77	14
B1_10 Zhvatje (reketim) i nxënësve/eve	122	31	0.69	15
B1_2 Ndëshkim fizik i nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave	90	23	0.54	16
B1_17 Rrahje në mes djemve dhe vajzave	111	28	0.53	17
B1_13 Mbajtja e shkopit ose drurit nga ana e nxënësve/eve	93	23	0.5	18
B1_7 Frikësim, kërcënim ndaj profesorëve/eshave nga ana e nxënësve/eve	93	23	0.48	19
B1_5 Përlëshje fizike mbi profesorët/eshat nga ana e nxënësve/eve	42	11	0.24	20
B1_14 Mbajtja e pistoletës nga ana e nxënësve/eve	37	9	0.2	21
B1_22. Forma tjera të sjelljes së dhunshme	20	5	0.12	22

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se pesë format e para e sjelljes së dhunshme (top 5) kanë të bëjnë me:

- Ofendimet, përqeshjet mes nxënësve/eve është një formë e sjelljes së dhunshme që me një rejting prej 2.76 pikë e kanë theksuar shumica e madhe prej 88% të 400 nxënësve të anketuar, ndërsa 12% janë përgjigjur se një formë e tillë e sjelljes së dhunshme nuk është asnjëherë e pranishme në shkollën e tyre. Kjo tregon se kur merren parasysh përgjigjet e të gjithë 400 nxënësve/eve të anketuar, mesatarisht kjo formë e sjelljes së dhunshme konsiderohet nga ata të jetë e pranishme dy deri në tre herë në muaj. Ky konstatim tregon se ofendimi dhe përqeshja në mes nxënësve është një faktor që ka ndikim të madh negativ në formimin e klimës së përgjithshme në shkolla. Për më tepër, shikuar kështu, ofendimet dhe përqeshjet, realisht mund të jenë faktorë fillestar të cilët do të kontribuojnë në raste të caktuara të jenë fazë e fillimit të ndonjë forme më të rëndë të sjelljes së dhunshme. Për këtë arsye, ekzistenca e përhapur e kësaj forme të sjelljes së dhunshme duhet të trajtohet si një sinjal në sistemin e paralajmërimit të hershëm për të parandaluar shfaqjen e formave më të rënda të sjelljes së dhunshme. Thënë me fjalë tjera, në funksion të kohës, nxënësit/et të cilët i nënshtrohen ofendimeve dhe përqeshjeve, në periudhë më të gjatë, tek ata vjen deri te grumbillimi i frustracioneve. Kur ata e tejkalojnë pragun kritik të tolerancës së frustrimit, edhe një ngjarje më pak e rëndësishme mund të jetë shkas që shpien deri në zbrazje të frustracionit i cili do të marrë formën e një akti më të rëndë të dhunës. Ose duhet të merret parasysh rreziku në mes atyre nxënësve/eve të cilët ofendojnë dhe përqeshin, nëse sjelljes së tyre në periudhë më të gjatë nuk i kushton vëmendje kësaj forme të sjelljes së dhunshme në masë të madhe mund t'i "inkurajojë" ata që të shfaqin ndonjë formë dhune me pasoja më të rënda. Domethënë, duhet të merret parasysh se edhe viktimat edhe iniciatorët e kësaj forme të dhunës kanë një potencial të strukturuar të ndryshëm latent për të gjeneruar forma të tjera të dhunës me pasoja më të rënda. Kësaj forme të dhunës si shumë të afëra nga efekti psikologjik duhet t'i shtohet efekti kumulativ ndaj rreziqeve latente për format e tjera të dhunës dhe ofendimit të "kryqëzuar" në mes nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave. Ky "rrjet" i lidhur i faktorëve të cilët veprojnë në interaksione të ndërsjella të caktuara sjellin deri në shumë forma të tjera të sjelljes së dhunshme. Ofendimet e ndërsjella ndërmjet nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave mund të shpiejnë, për shembull, në frikësimin e nxënësve/eve ndaj profesorëve/eshave dhe anasjelltas, ose të eskalojë në një përleshje fizike ndaj profesorëve/eshave nga ana e nxënësve/eve ose ndëshkime trupore të nxënësve/eve nga profesorët/eshat. Shikuar më gjerësisht, format e ndryshme të dhunës shpesh kanë gjenezë në përvojat e mëparshme me manifestimin e sjelljes së dhunshme. Për këtë arsye, format e sjelljes së dhunshme nuk duhet të vëzhgohen në mënyrë të izoluar nga njëra-tjetra. Në këtë kontekst, analiza nuk sjell deri tek supozimi themelor se secila formë e dhunës përcaktohet në mënyrë specifike nga një grup faktorësh siç janë premiset e mëparshme në formimin e përmbajtjes konkrete specifike. Këto supozime të bazuara në lidhje me gjenezën e një strukture specifike të marrëdhënieve me format e tjera të sjelljes së dhunshme, imponojnë nevojën për bashkëpunim në zgjidhjen e dhunës dhe pjesëmarrjen e profesionistëve dhe personave kompetent, siç janë psikologët e shkollës, pedagogët, sociologët, respektivisht përfshirja aktive dhe bashkëpunimi i shërbimeve profesionale. Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se duhet të definohen normativat realiste të psikologëve të shkollës me sa nxënës/e mund të punojë një psikolog shkollor, që t'u mundësojë atyre të merren me problemet në mënyrë më efektive.
- Forma e rradhës, e cila është në vendin e dytë në listën e rejtingut të sjelljes së dhunshme është shkatërrimi i inventarit shkollor me rejting 1.82 për të cilin janë shprehur 84% të të anketuarve, që do të thotë se frekuenca mesatare e perceptimeve të nxënësve/eve për këtë formë të sjelljes së dhunshme përafërsisht shfaqet një herë në muaj. Kjo formë e sjelljes së dhunshme tregon që nxënësit/et të cilët kryejnë forma të tilla sjelljeje janë "plot" frustracione të cilat nuk munden ndryshe t'i manifestojnë dhe mekanizmi i frustrimit-agresionit është projektuar në botën e sendeve/objekteve rreth tyre ndërsa shprehet në këtë mënyrë. Kjo formë e sjelljes së dhunshme tregon se në profilin psikologjik të nxënësit/es "fshihet" përmbajtje e grumbulluar në pavetëdijen të cilat "presin" një rast ose situatë të caktuar për t'u manifestuar. Në fakt, për shkak të mungesës së mekanizmave për t'u ballafaquar me ndjenjën e agresionit, shkatërrimi i pronës është një mënyrë për të "ventiluar" agresionin në mungesë dhe mosnjohjen e mënyrave të tjera për të shprehur zemërimin.
- Përqindjet e larta të cilat kanë të bëjnë me ofendimet dhe përqeshjet si dhe shkatërrimin e inventarit të shkollës tregojnë edhe se shkolla nuk ka kapacitete dhe aftësi të zhvilluara tek profesorët/



eshat për t'u ballafaquar me këto forma të sjelljes së dhunshme ose disa prej tyre janë tolerantë ndaj këtyre formave të dhunës, respektivisht qëndrimet e tyre ndaj këtyre formave të dhunës janë relative. Për këtë arsye, sanksionimi i formave të ndryshme të dhunës mund të ketë vetëm një efekt afatshkurtër dhe madje të përkeqësojë situatën, dhe për këtë arsye dënimi duhet të jetë i pranishëm si mjete i fundit në përpjekje për të korigjuar sjelljen e autorëve të dhunës. Efekte më të qëndrueshme dhe më afatgjate janë veprimet parandaluese nëpërmjet organizimit të debateve, punëtorive dhe komunikimeve me nxënësit/et në tema të caktuara. Ndërsa në rastet e formave më të rënda të sjelljes së dhunshme, është epashmangshme edhe qasja individuale me psikologët e shkollës, pedagogët dhe autoritetet e tjera kompetente në sistemin arsimor.

- Në vendin e tretë në listën e rejtingut me 1.7 pikë rejtingu të deklaruar nga një shumicë shumë e madhe e nxënësve/eve (82%) janë rrahjet në mes nxënësve/eve. Fakti që në kuadër të tërë mostrës nxënësit/et shprehen se rrahjet ndodhin mesatarisht një herë në muaj, sa i përket vëllimit të ngjarjeve, klima e përgjithshme në shkolla është seriozisht e afektuar. Kjo gjithashtu shpjen edhe deri tek ndryshimi i qëndrimit ndaj rrahjeve në mes nxënësve/eve, respektivisht me kalimin e kohës nxënësit/et i shohin rrahjet si diçka që është e zakonshme dhe përsëritet vazhdimisht. Ndoshta ky ndryshim i pavetëdijshëm në qëndrimin ndaj rrahjeve është me potencial për ta ulur pragun e tolerancës e rrahjeve në mes nxënësve/eve<sup>13</sup>. Në këtë mënyrë hapet rrethi magjik i frekuencës më të madhe të rrahjeve në mes nxënësve/eve - ulja e pragut të tolerancës të rrahjeve nga ana e mjedisit. Kjo nga ana e vet nxit që më lehtë të manifestohen impulse agresive të cilat rezultojnë me rrahje. Një skemë tjetër themelore është rrahjet të shpiejnë drejt dëshirës së “hakmarrjes” të anës së “mposhtur”. Këtu mund të shtrohet edhe pyetja se sa mekanizmat për zgjidhjen e rrahjeve në shkolla funksionojnë, çfarë mekanizmash përdoren, nëse dhe sa raste zgjidhen me sukses dhe me cilat procedura dhe masa?
- Në dy vendet e rradhës listën e rejtingut të formave të sjelljes së dhunshme janë: ofendimet e nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave që kane theksuar 67% të nxënësve/eve të anketuar me një rejting mesatar prej 1.58 dhe në vendin e pestë është ofendimi i profesorëve/eshave nga ana e nxënësve/eve, që e kanë shënuar 55% nga nxënësit/et e anketuar/a me rezultat rejtingu mesatar 1.2. Edhe pse shumica e të anketuarve kanë vendosur për të dy format e sjelljes së dhunshme, megjithatë akoma më e theksuar është prezenca e formës të ofendimit të nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave në krahasim me formën e kundërt. Këta të dhëna janë dëshmi se ka tregues të përhapur empirik të cilët sugjerojnë se edhe tek nxënësit/et edhe tek profesorët/eshat ekzistojnë predispozita për konflikt në mes tyre. Duhet theksuar se masat parandaluese në Arsimin paqësor shumë pak janë të drejtuara në kahje të këtij lloji të konflikteve si dhe në shoqërinë në tërësi. Duket se shoqëria nuk është akoma e gatshme për ta hapur këtë çështje. Por pikërisht për këtë shkak duhet të punohet me profesorët/eshat në zhvillimin e vetëdijes më të madhe për rolin e tyre si pedagogë, se ata vazhdimisht duhet të identifikojnë dhe kenë në mend cilat janë karakteristikat e moshës me të cilën punojnë. Në adoleshencë, për shembull, aspekti zhvillimor është konfrontimi me autoritetet. Gjithashtu duhet të punohet edhe në drejtim që profesorët/eshat t'i identifikojnë konfliktet dhe në vend që të hyjnë në konflikt me nxënësit/et, t'i menaxhojnë ata në mënyrë objektive, me çka nuk do të vinin në situatë të reagojnë në mënyrë të pavetëdijshme, iracionale-infantile me çka do të “involveheshin” një grindje me nxënësit/et. Nëse gjendjet në këtë plan mbeten të pandryshuara, treguesit e këtyllë janë indikacion që edhe në periudhën e ardhshme një pjesë e masave parandaluese të marra në procesin e Arsimit paqësor do të humben ose zvogëlohen në vorbullën e situatave konfliktuoze në mes nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave.
- Për Arsimin paqësor, është e rekomandueshme të fillojnë me përgatitjen e terrenit për këtë temë, sepse pjesa më e madhe e bullingut përfshin maltretimin e nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave.

Me analizën e mëtutjeshme të listës së rejtingut ndahen format e dhunës që kanë potencial të lartë për të shkaktuar dhunë me pasoja të rënda janë:

- mbajtja e thikës që gjendet në vendin e nëntë në listën e rejtingut, të cilën e theksojnë 41% e të anketuarve dhe ka 0.95 pikë rejtingu, që do të thotë se ka paraqitje shumë e rrallë.
- mbajtja e një druri ose shkopi gjendet në vendin e 17-të në listën e rejtingut të e cilën e theksojnë 23% të nxënësve/eve të anketuar me 0,5 pikë vlerësimi, që do të thotë se kjo shfaqet edhe më rrallë se forma e mëparshme.
- bajtja e armëve gjendet në vendin e 21-të në listën e vlerësimit, të cilën e kanë theksuar 9% e të anketuarve me 0.2 pikë vlerësimi.

Edhe pse të tre format janë të rralla, mbajtja e thikës theksohet nga një përqindje e konsiderueshme e nxënësve/eve (41%) që krijojnë një ndjenjë të pasigurisë dhe frikës tek shumë nxënës/e, në numër më të vogël i referohet mbajtjes së drurit ose shkopit dhe më pak e pranishme është tek mbajtja e pistoletës. Për shkak të potencialit të lartë për të shkaktuar dhunë me pasoja shumë të rrezikshme, imponohet nevoja e synimit të tyre me qëllim që të zbulohen ato dhe në këtë mënyrë të përmirësohet atmosfera e përgjithshme e sigurisë në mesin e nxënësve/eve.

### ***Perceptimi i formave të sjelljes së dhunshme të nxënësve/eve në varësi të përbërjes etnike të nxënësve/eve në shkollë në vitin 2019***


Me qëllim që të marrim njohuri nëse dhe në çfarë mase është ndikimi i dallimit të përbërjes etnike në shkollat e mesme, kemi bërë vëzhgimin në kuadër të ndarjes së:

- shkolla homogjene me nxënës/se maqedonas dhe përkatësi të tjera etnike (prania e të cilave është në numër shumë të vogël) ku janë anketuar gjithsej 105 nxënës/e
- shkolla homogjene me nxënës/e shqiptarë ku janë anketuar 53 nxënës/e
- shkolla heterogjene ku ka nxënës/e nga përkatësia etnike maqedonase, shqiptare dhe nxënës nga përkatësitë tjera etnike ku janë anketuar 242 nxënës/e

Analiza krahasuese në mes këtyre tre kategorive të shkollave në përgjithësi tregon se për ata forma të dhunës ku ekzistojnë dallime, në numër më të madh janë të moderuara, ndërsa në pjesën më të madhe bëhet fjalë për dallime në nijansa.

E përbashkët për të tre kategoritë të shkollave në radhë të parë në listat e rejtingut gjendet ofendimi dhe përqeshja në mes nxënësve/eve. Në grafikun 4 shihet se kjo formë në shkollë ka rezultatin më të lartë mesatar të rejtingut në shkollën homogjene shqipe (ShMQSh Gjinnazi “Zef Lush Marku”) e cila është 3.04 e theksuar nga 89% e nxënësve/eve, që praktikisht do të thotë se ekziston një konsensus midis nxënësve/eve në këtë shkollë sa i përket pranisë së kësaj forme të dhunës në shkollë. Në homogjenet M + me njërezultat mesatare rejtingu prej 2.89 theksohet nga 92% e nxënësve në këta shkolla. Gjithashtu në shkollat heterogjene, kjo formë e dhunës është në radhë të parë me njërezultat mesatare prej 2.64, e theksuar se është e pranishme nga 85% të nxënësve në këta shkolla.

**Grafiku 4**



Këta indikatorë tregojnë se në të tre kategoritë e shkollave pozicioni më i lartë në listat e rangimit është ajo formë të cilën e vlerësuam të përmbante potencial të lartë latent që me kalimin e kohës shpjen deri në shfaqjen e formave tjera më të rrezikshme të dhunës sipas pasojave të cilat i shkaktojnë. Kjo do të thotë se sipas të gjitha gjasave në tërë universin e nxënësve/eve në shkollat e mesme “kanoset” rreziku i mirëmbajtjes së nivelit të dhunës në shkolla edhe përkundër përpjekjeve për uljen e dhunës nëpër shkolla. Për këtë arsye, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet kësaj forme të përhapur të dhunës në studimin e faktorëve të cilët e përcaktojnë atë për shkak të toksicitetit të lartë të klimës së përgjithshme psikologjike në shkollat e mesme. Në fakt, kjo formë e dhunës ka karakter universal dhe është e pranishme në të gjitha segmentet shoqërore (përqeshje, nënvlerësim...). Është e përhapur në mesin e prindërve dhe kolegëve në punë dhe në forma të ndryshme të komunikimit shoqëror në grupe të ndryshme shoqërore. Nëse nisemi nga ky supozim se në shtritje variabile i “kontaminon” lidhjet sociale mund të supozojmë se lufta kundër dhunës është pashmangshmërisht e vështirë dhe duhet të zhvillohet në mënyrë sistematike si dhe në afat më të gjatë me ballafaqimin se arritja më e lartë e mundshme është ulja e rreziqeve nga sjellja e dhunshme, ndërsa në asnjë mënyrë edhe eliminimi i saj i plotë.

Tek shkollat homogjene M +, në vendin e dytë plasohet shkatërrimi i inventarit shkollor me rezultatin e rejtingut 1.90, në vendin e tretë janë rrahjet në mes nxënësve/eve me rezultatin e rejtingut 1.54, në vendin e katërt janë ofendimet e profesorëve/eshave nga nxënësve/eve me rezultatin e rejtingut 1.36 dhe në vendin e pestë është ofendimi i nxënësve/eve nga ana profesorëve/eshave me rezultatin e rejtingut 1.16..

Tek shkollat homogjene shqiptare<sup>14)</sup> në vendin e dytë është ofendimi i nxënësve/eve nga ana profesorëve/ me rezultatin e rejtingut 2.25, në vendin e tretë janë rrahjet në mes nxënësve/eve me rezultatin e rejtingut 1.66, në vendin e katërt janë vjedhjet e sendeve personale me rezultatin e rejtingut 1.57 dhe në vendin e pestë është shkatërrimi i inventarit shkollor me rezultatin e rejtingut 1.36.

Tek shkollat heterogjene, në vendin e dytë është shkatërrimi i inventarit shkollor me rezultatin e rejtingut 1.77, në vendin e tretë janë rrahjet në mes nxënësve/eve me rezultatin e rejtingut 1.77, në vendin e katërt është ofendimi i nxënësve/eve nga ana profesorëve/eshave me rezultatin e rejtingut 1.61 dhe rrahjet në mes nxënësve/eve nga përkatësitë e ndryshme etnike është në vendin e pestë me rezultatin e rejtingut prej 1.28.

Këta të dhëna tregojnë se atmosfera e përgjithshme në të tre kategoritë e shkollave sipas përbërjes nacionale faktor i përbashkët është ofendimi dhe përqeshja e cila tek të gjithë është në radhë të parë dhe rrahjet në mes nxënësve/eve e cila është në vendin e tretë në të tre kategoritë. Faktori i dytë i përbashkët është se fyerjet në mes profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve janë të ndërsjella dhe është faktor i përbashkët i determinimit të klimës në shkolla në ata homogjene M + dhe shkollat heterogjene. Në shkollën homogjene A paraqet prezencë të ofendimeve të nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave që është me rezultat rejtingu prej 2.25. Kjo tregon në faktin se modelin tradicional i edukimit i pranishëm nëpër familje është i pasqyruar në sistemin arsimor. Kjo e dhënë tregon se 89% e nxënësve/eve në këtë shkollë e theksojnë këtë formë të dhunës, ndërsa 7 nga 10 profesorë/eshat nga ana tjetër deklarojnë se profesorët/eshat janë ata që fyejnë nxënësit/et. Edhe një faktor i cili e determinon klimën në shkollat homogjene A ndërsa gjithashtu edhe i ndan ata nga kategoritë e tjera të shkollave është vjedhja e sendeve personale dhe kjo formë e dhunës është në vendin e njëmbëdhjetë tek M + homogjenet a tek shkollat heterogjene është në vendin e 12-të.

Fakti që në të tre kategoritë e shkollave, në mes pesë formave të para të dhunës në shkollë variable është i pranishëm shkatërrimi i inventarit të shkollës, tregon se tek nxënësit/et ekzistojnë impulse destruktiviteti ndaj mjedisit përreth. Kjo do të thotë se në të gjitha kategoritë e shkollave tek një pjesë e konsiderueshme e nxënësve/eve ekziston tendencë për shkatërrim, thyerje, prishje, agresion, gjë që tregon se ata nuk kanë arritur të integrohen në një mënyrë konstruktive në mjedisin shkollor.

Në vendin e dytë të listave të rejtingut është shkatërrimi i inventarit shkollor. Tek shkollat homogjene M + me rezultat rejtingu 1,90 dhe në shkollat heterogjene nacionale rezultati i rejtingut është 1.88. Ndërsa tek shkollat homogjene A kjo formë është në vendin e tretë në rejting listën me rezultat 1.36, ndërsa në vendin e dytë tek këta shkolla janë rrahjet në mes nxënësve/eve me rezultat rejtingu 1,66. Perceptimi i kësaj forme të dhunës përfshin një shumicë tejet të madhe të nxënësve/eve prej 72% tek shkolla homogjene A, deri në 88% tek shkollat homogjene M +.

Dhe në vendin e tretë gjithashtu me një rezultat relativisht të lartë rejtingu me përfshirje të lartë të perceptimit të kësaj forme të dhunës janë rrahjet në mes nxënësve/eve. Rezultat më i lartë rejtingu është regjistruar në shkollat heterogjene nacionale me rezultat rejtingu 1,77 e theksuar prej 81% të nxënësve/eve, pastaj vijojnë shkollat homogjene A me rezultat rejtingu 1.66 me përfshirje të perceptimeve të nxënësve prej 85% dhe në shkollat homogjene M + rezultati i rejtingut është 1.54 dhe përfshirja e perceptimit në mes nxënësve/eve është 83%.


### ***Perceptimi i formave të sjelljes së dhunshme në mes nxënësve/eve në shkollat e Shkupit në krahësim me shkollat jashtë Shkupit në vitin 2019***

Analiza e rezultateve tregon se nga pesë format të ranguar në vendet e para, katër të parat kanë të njëjtin pozicion të rangimit edhe shkollat në Shkup edhe në shkollat jashtë Shkupit. Përkatësisht, në radhë të parë në të dy kategoritë e shkollave janë ofendimi, përqeshja e nxënësve/eve me rezultat rangimi 2,92 në Shkup dhe 2.66 në shkollat jashtë Shkupit. Në vendin e dytë është shkatërrimi i inventarit shkollor 1.88 / 1.77 brenda dhe jashtë Shkupit. Në vendin e tretë janë rrahjet ndërmjet nxënësve/eve 1.69 / 1.70 brenda dhe jashtë Shkupit dhe në vendin e katërt është ofendimi i nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave përkatësisht 1.68 / 1.52. Ndërsa forma e dhunës e ranguar në vendin e pestë dallon me atë se në vend të pestë në shkollat në Shkup me rezultat rezultati rejtingu 1,32 është mbajtja e thikës nga nxënësit/et në raport me rangimin në vendin e trembëdhjetë në shkollat jashtë Shkupit me rezultat vlerësimi 0,72. Këto të dhëna tregojnë se ek-

<sup>14)</sup> Në mostrën sondazhit prej vitit 2019 përfaqësues i shkollave homogjene shqipe është vetëm “Zef Lush Marku” dhe kjo është arsyeja pse në disa pjesë të analizës kur shkruhet për të vetmen shkollë homogjene shqipe është shkruar në shumës. (shkruhet si “shkollat homogjene A”)

ziston një rrezik më i lartë i incidenteve fatale në Shkup. Në shkollat jashtë Shkupit ofendimi i profesorëve/eshave nga ana e nxënësve/eve me rezultat rejtingu 1,14 është në vendin e pestë, që paraqet specifikë për shkollat jashtë Shkupit ku ka ofendime të ndërsjella ndërmjet nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave. Këto të dhëna mbështesin modelet tradicionale të edukimit, të cilat janë më të përhapura në zonat rurale. Sa më shumë që nxënësit/et ofendohen nga ana e profesorëve/eshave, aq më shumë ata e mësojnë modelin dhe më pas ofendojnë vetë. Duhet të theksojmë faktin se nxënësit/et nga familjet më konzervative tradicionale shpesh jetojnë të njëjtin model edhe në familje, për dallim prej familjeve në të cilat mbizotëron një model më liberal i edukimit. Me këtë shembull mundet shumë qartë të ilustruhet rëndësia e përfshirjes së prindërve në programin e Arsimit paqësor.

**Grafiku 5**



### *Forma të tjera të dhunës me ndikim më të vogël në raport me kategoritë e analizës (shkolla hetergjene / homogjene dhe shkollat jashtë Shkupit) (2019)*

Format e dhunës që janë më të shprehura në shkollat në Shkup në raport me të gjitha kategoritë tjera janë këto:

- rrahje me nxënës/e nga shkolla tjera, me rezultat rejtingu 1,13
- frikësime dhe kërcënime ndaj nxënësve/eve, me rezultat rejtingu 1.08
- frikësime, kërcënime nga persona të jashtëm, me rezultat rejtingu 1.08
- mbajtja e drurit ose shkopit nga ana e nxënësve/eve, me rezultat rejtingu 0.64
- mbajtja e pistoletës nga ana e nxënësve/eve, me rezultat rejtingu 0.33

Më tej, format e dhunës të cilat janë me ndikim më të vogël, por janë më së shumti të shprehura në shkollat me përbërje heterogjene janë:

- izolimi, me rezultat rejtingu 1.06
- rrahje në mes vajzave dhe djemve, me rezultat rejtingu 0.64
- përlëshje fizike ndaj profesorëve/eshave nga ana e nxënësve/eve, me rezultat rejtingu 0.31

Izolimi si një specifikë në shkollat heterogjene mund të ketë pasoja më të vogla. Përkatësisht, nëse izolimi ndodh në mes nxënësve/eve të përkatësive të ndryshme etnike mund të ketë kuptimin “nuk më ofendojmë e as nuk më rrahin, por ndëshkohem me izolim, sepse unë jam nga një komunitet tjetër etnik”. Faktikisht, në rrethana të tilla megjithatë shmangen format më të rënda të dhunës.

Kategoria e tretë në të cilën theksohen format e dhunës me ndikim më të ulët është më e theksuar tek shkollat homogjene me nxënës të përkatësisë etnike Shqiptare:

- SMS porosi me përmbajtje jo të këndshme, me rezultat rejtingu 1.26
- prekja e trupit në mënyrë të papërshtatshme, me rezultat rejtingu 0.91
- zhvatje, reketim i nxënësve/eve, me rezultat rejtingu 0.91
- ndëshkim fizik i nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave, me rezultat rejtingu 0.68
- frikësim, kërcënim mbi profesorët/eshat nga ana e nxënësve/eve, me rezultat rejtingu 0.53

### ***Krahasimi i perceptimeve të formave të dhunës ndërmjet nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave (2019)***

Krahasimi i perceptimit të formave të dhunës në shkolla, nga hulumtimi i kryer në vitin 2019, tregon një shkallë të lartë të përputhjes në mes profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve. Edhe tek njërit edhe tek tjetrët, ofendimet dhe përqeshjet janë në vendin e parë në mes nxënësve/eve që u theksua nga 94% e profesorëve/eshave me rezultat rejtingu 1.59<sup>15)</sup> dhe 88% të nxënësve/eve me rezultat rejtingu 0.76, me çka duke marrë parasysh se shkallët e dallimeve diferencojnë ndërmjet niveleve, mund të konkludohet se tek nxënësit/et në shkallë të caktuar perceptimi është me intenzitet më të madh. Shqyrtimi dytë në këtë krahasim në mes perceptimeve të profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve është fakti që përqindja mesatare e përgjigjeve e të gjitha formave të dhunës në një përqindje dukshëm më të lartë të profesorëve/eshave është 74% në krahasim me 57% të formave të dhëna mesatarisht nga ana e nxënësve/eve. Ky ndryshim ndoshta buron nga fakti që nxënësit/et në numër më të vogël identifikojnë forma të caktuara të dhunës. Kështu, kur shikojmë izolimin në formë të dhunës, 81% e profesorëve/eshave e shohin atë si të tillë për dallim prej 44% nga nxënësit/et. Ngjashëm me këtë, si njohje më e vogël e formës së dhunës janë SMS mesazhet me përmbajtje të pakëndshme. Të dhënat tregojnë se 81% e profesorëve/eshave theksojnë si dhunë të pranishme në shkollë për dallim me vetëm 40% të nxënësve të cilët e theksojnë si dhunë.

**Tabela 17**

<b>Krahasimi i perceptimeve të formave të dhunës ndërmjet nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave</b>				
Forma të dhunës <b>2019</b>	Nxënësit/et		Profesorët/eshat	
	Rejtingu	% i/e të anketuarve të cilët/at kanë theksuar dhunë të caktuar	Rejtingu	% i/e të anketuarve të cilët/at kanë theksuar dhunë të caktuar
B1_9 Ofendime, përqeshje në mes nxënësve/eve (P1_2)	2.76	88	1.59	94
B1_15 Rrahje në mes nxënësve/eve – dhunë fizike (P1_1)	1.70	82	1.03	86
B1_19 Izolim (P1_4)	1.02	44	1.08	81
B1_21 SMS mesazhe me përmbajtje të pakëndshme (P1_6)	0.86	40	1.04	73
B1_10,11 Pikët mesatare të zhvatjes, vjedhjeve (P1_5)	0.79	77	0.65	61
B1_20 Prekje të trupit në mënyrë jokorekte (P1_3)	0.77	35	0.52	48
% mesatare e përgjigjeve e të gjitha pyetjeve		57		74

***Krahasimi i perceptimeve të dhunës prej nxënësve/eve mbi profesorët/eshat (2019)***

Në këtë rast në dispozicion për krahasim na qëndrojnë vetëm tre forma të dhunës së nxënësve/eve ndaj profesorëve/eshave të cilat janë praktikisht me të njëjtin intencion por me formulime të ndryshme të paraqitura tek pyetësorët.

Perceptimi i profesorëve/eshave në lidhje me dhunën nga ana e nxënësve/eve ndaj tyre tregon se mesatarisht vetëm 29% e profesorëve/eshave përgjigjen se mbi ata ushtrohet dhunë. Më shumë përgjigje që profesorët/eshat i perceptojnë si dhunë e nxënësve/eve ndaj tyre paraqesin thashethemet në 92% të rasteve me rezultat rejtingu 0.92. Pastaj vijon ofendimi që e kanë theksuar 36% të profesorëve me rezultat rejtingu 0.36. Për dallim prej kësaj këtë lloj dhune e theksojnë 55% e nxënësve/eve me rezultat rejtingu 1.2. Ndërsa përqindja më e ulët e profesorëve/eshave 2%, kanë deklaruar se kanë qenë të goditur ose shtyrë nga nxënës/e. Por nga ana tjetër 11% e nxënësve/eve u përgjigjën me me rezultat rejtingu 0.24 se është prezente goditja ose shtyerja e profesorit/eshës nga ana e nxënësit/es.

**Tabela 18**

<b>Krahasimi i perceptimeve të formave të dhunës ndërmjet nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave</b>				
Dhuna të përfaqësuara nga nxënësit/et mbi profesorët/eshat <b>2019</b>	Nxënësit/et		Profesorët/eshat	
	Rejtingu	% i/e të anketuarve të cilët kanë theksuar dhunë të caktuar	Rejtingu	% i/e të anketuarve të cilët kanë theksuar dhunë të caktuar
P2_1. Dikush ju ka ofenduar (B1_6)	1,2	55	0.36	36
P2_2 Dikush ju ka folur fjalë fyese			0.28	28
P2_3 Dikush ju ka kërcënuar (B1_7)	0,24	23	0.18	18
P2_4 Dikush Ju ka goditur ose shtyrë (B1_5)	0,24	11	0.02	2
P2_5 Dikush ju ka shkatërruar gjëra me qëllim			0.12	12
P2_6 Ju kanë larguar (izoluar)			0.15	15
P2_7 Dikush ju ka përgojuar			0.92	92
% mesatare e përgjigjeve e të gjitha pyetjeve		30		29

***Krahasimi i perceptimeve të dhunës nga ana e profesorëve/eshave mbi nxënësit/et (2019)***

Shikuar mesatarisht në përqindje të ngjashme përgjigjen profesorët/eshat (41%) dhe nxënësit/et (44%) për praninë e formave të caktuara të dhunës. Gjithashtu edhe format e dhunës të cilat mund t'i krahasojmë përgjigjet janë në një përqindje shumë të ngjashme. Vetëm se në tre format e dhunës nga ana e profesorëve/eshave ndaj nxënësve/eve, intensiteti është më i fortë nga ana e nxënësve/eve në rezultatet e rejtingut. Nga të gjitha përgjigjet e kësaj pyetje, përgjigjet më të pranishme nga ana e nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave janë që profesorët/eshat flasin fjalë abuzive ndaj nxënësve (tek 67% e nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave është me rezultat rezultate rejtingu - 1,58 tek nxënësit/et dhe 0.83 tek profesorët/eshat). Për 4 format e tjera të dhunës për të cilat ne nuk kemi të dhëna krahasuese, thashethemet e nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave janë më të theksuara me 62% nga profesorët/eshat me rezultat rejtingu 0.78 ndërsa vëllimi i perceptimit të profesorëve/eshave është se më së paku iu shkatërrohen gjërat e nxënësve/eve (rezultati i rejtingut 0.19).

Analiza e perceptimeve të profesorëve/eshave të cilët janë anëtarë të Arsimit paqësor tregon se në radhë të parë janë theksuar thashethemet e nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave me rezultat rejtingu 0.91, në vendin e dytë është perceptimi se profesorët/eshat iu flasin nxënësve/eve fjalë abuzive me rezultat rejtingu 0.89 dhe izolimi i nxënësve/eve nga ana e profesorëve/eshave me rezultat rejtingu 0.80. Nga ana tjetër, profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e Arsimit paqësor me notën më të lartë të vlerësimit janë përgjigja e perceptimit që profesorët/eshat flasin fjalë abuzive për nxënësit/et me rezultat rejtingu 0.67 dhe thashetheme për nxënësit/et me rezultat rejtingu 0.63. Edhe pse bëhet fjalë për nijansa, megjithatë tendenca themelore është që profesorët/eshat të cilët janë pjesë e Programit për arsim paqësor ta vlerësojnë dhunën e profesorëve/eshave ndaj nxënësve/eve me një vlerësim më të lartë se profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e Arsimit paqësor. Thënë shkurtimisht, profesorët/eshat të cilët janë pjesë e Arsimit paqësor kanë qëndrim më kritik.

Profesorët/eshat nga Shkupi në radhë të parë shprehin izolimin 0.83 (r.r.), pastaj të drejtuarit me fjalë abuzive ndaj nxënësve/eve dhe thashethemet e nxënësve/eve me rezultat rejtingu 0.80. Profesorët/eshat jashtë Shkupit me notën më të lartë të rejtingut e perceptojnë të biseduarin me fjalë abuzive ndaj nxënësve/eve me rezultat rejtingu 0.82, përcjellur nga thashethemet e nxënësve me rezultat rejtingu 0.77 dhe në vendin e tretë është izolimi me rezultat rejtingu 0.69. Praktikisht, të dhënat të cilat i paraqitëm tregojnë se ndryshimet janë shumë të vogla dhe dhe në nijansa.



**Tabela 19**

Krahasimi i perceptimeve të formave të dhunës ndërmjet nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave				
Dhuna të përfaqësuara nga ana e profesorëve/eshave mbi nxënësit/et <b>2019</b>	Nxënësit/et		Profesorët/eshat	
	Rejtingu	% i/e të anketuarve të cilët kanë theksuar dhunë të caktuar	Rejtingu	% i/e të anketuarve të cilët kanë theksuar dhunë të caktuar
P3_1 Profesori/esha i ka folur fjalë fyese (B1_3)	1,58	67	0,83	67
P3_2 Profesori/esha iu është kërcënuar (B1_4)	0,94	42	0,62	48
P3_3 Profesori/esha i ka goditur ose shtyrë (B1_2)	0,54	23	0,21	20
P3_4 Profesori/esha me qëllim i ka shkatërruar sende			0,19	16
P3_5 Profesori/esha i ka larguar (izoluar)			0,73	54
P3_6 Profesori/esha i ka përgojuar			0,78	62
P3_7 Profesori/esha ka prekur trupin e nxënësit/es në mënyrë të palejuar			0,21	18
% mesatare e përgjigjeve e të gjitha pyetjeve		44		41

## 6. Perceptimi i rrahjeve nga ana e nxënësve/eve (2019)

Në tabelën 20 janë shfaqur katër format e rrahjeve të cilat janë temë e hulumtimit të kryer në vitin 2019 nëpër shkolla. Perceptimi i nxënësve/eve për rrahjen në mes nxënësve/eve në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me rrahjet në mes nxënësve/eve në përgjithësi, për të cilat 82% e nxënësve/eve me 1.7 rezultat rejtingu kanë deklaruar se janë të pranishme në shkollat e tyre. Në vendin e dytë janë rrahjet në mes nxënësve të përkatësive të ndryshme etnike në 60% të rasteve merezultat rejtingu 1.14, ndërsa pas tyre vijnë rrahjet me nxënës/e të shkollave të tjera me 56% dhe me rezultat rejtingu 1.07. Më së paku theksohen rrahjet në mes vajzave dhe djemve ku përqindja është 28% me rezultat rejtingu 0.53.

Mesatarja e rezultatit të rejtingut prej të gjitha 4 formave të rrahjeve në shkolla heterogjene vlerësohet në 1.20. Në shkollat homogjene M + rezultati është 0.98 dhe në shkollat homogjene A është 0.94. Krahasimi në mes shkollave në Shkup dhe jashtë Shkupit tregon se për nijansë të caktuar janë më të pranishme rrahjet jashtë Shkupit me rezultat rejtingu 1.14 ndërsa në Shkup me rezultat 1.06.

**Tabela 20**

Perceptimi i rrahjeve nga ana e nxënësve/eve <b>2019</b>	% e nxënësve/eve të cilët kanë theksuar dhunë të caktuar	Rejtingu
B1_15 Rrahje në mes nxënësve/eve	<b>82%</b>	1.7
B1_16 Rrahje në mes nxënësve/eve me përkatësi të ndryshme etnike	<b>60%</b>	1.14
B1_17 Rrahje mes vajzave dhe djemve	<b>28%</b>	0.53
B1_18 Rrahje me nxënës/e prej shkollave tjera	<b>56%</b>	1.07
Mesatarja e rrahjeve të deklaruara nga ana e nxënësve/eve të cilët kanë theksuar dhunë të caktuar	56%	1.11

### Perceptimi i nxënësve/eve për vendin e rrahjeve në mes nxënësve/eve (2019)

Kjo pyetje është me mundësi për më shumë përgjigje dhe rezultatet e tregojnë gjandjen në vijim: numri më i madh i rrahjeve ndodhin në oborrin e shkollës (60%), pastaj vijnë rrahjet nëpër korridore (32%) dhe në vende tjera (parqe, palestra sportive, disko klube, bare/kafeteri, qendra tregtare etj.) (27%). Nga analiza e rezultateve të perceptimeve të nxënësve/eve në lidhje me vendin ku ndodhin rrahjet, na sjellin drejt konkludimit se ata ndodhin në shkollë, por kur nuk ka mbikëqyrje.

Kur i vëzhgojmë shkollat, pavarësisht a janë homogjene ose heterogjene apo në Shkup ose jashtë Shkupit, në mënyrë konstante mbetet në radhë të parë se numri më i madh i rrahjeve ndodhin në oborret e shkollave. Në vendin e dytë janë korridoret ku ndodhin rrahjet sipas deklaratave të 30% prej të anketuarve. Dhe afër kësaj, 27% prej rrahjeve ndodhin në vende tjera jashtë shkollës. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e të rrahjeve të cilat ndodhin jashtë shkollave janë stacionet e autobusëve (21%) dhe çdo rrahje e 10-të ndodh nëpër autobusë.

**Tabela 21**

Perceptimi i nxënësve/eve	Përgjigjet e të gjithë 400 nxënësve/eve të anketuar/a			Përgjigjet e viktimave të dhunës	
	B2 Në cilat vende ndodhin rrahjet mes nxënësve/eve	Raste	% në kolonë	Raste	% në kolonë
2019	1 Në shkollë	99	25	42	30
	2 Në korridoret e shkollës	127	32	56	40
	3 Në toalete	50	13	21	15
	4 Në oborrin e shkollës	240	60	93	66
	5 Në stacionin e autobusëve	85	21	33	23
	6 Në autobus	40	10	14	10
	7 Në vend tjetër	108	27	33	23
	8 Nuk ka rrahje në shkollë	20	5	2	1
Gjithsej		400	192	141	208

Për një hartografim sa më të saktë të vendeve ku më shpesh ndodhin rrahjet i kemi marrë parasysh përgjigjet e nxënësve/eve të cilët kanë deklaruar se kanë qenë viktimat të dhunës. Përgjigjet e viktimave të dhunës konfirmojnë se rrahjet (66%) më së shpeshti ndodhin në oborret shkollore, korridoret e shkollës (40%) janë pika e dytë kritike, e ndjekur nga klasat (30%), dhe pothuajse çdo e katërta rrahje ndodh në stacionet e autobusëve dhe vendet e tjera me nga 23% për të dy lokacionet. (shiko Tabelën 21)

### Perceptimi i nxënësve/eve rreth kohës kur ndodhin rrahjet në mes nxënësve/eve (2019)

Variacionet në perceptimet në mes nxënësve/eve dhe profesorëve/eshave se kur ndodhin rrahjet në mes nxënësve/eve tregojnë një ngjashmëri të madhe si në strukturën ashtu edhe në shpeshhtësinë e përgjigjeve. Përrjashtim bëjnë përgjigjet e nxënësve/eve se mbi gjysma e rrahjeve (52%) ndodhin kur kthehen nga shkolla dhe është në vendin të parë sipas shpeshhtësisë së përgjigjeve. Tëk profesorët/eshat në vend të parë është përgjigja se rrahjet ndodhin gjatë pushimeve (48%). Megjithëse ky dallim është i parëndësishëm para së gjithash ka të bëjë me mundësitë e ndryshme perceptuese në mes profesorëve/eshave dhe nxënësve. Përkatësisht, profesorët/eshat nuk kanë mundësi të shohin saktësisht se çfarë po ndodh me nxënësit kur kthehen nga shkolla, ose mund të marrin ide rreth kësaj pasi që të informohen nga dikush.

**Tabela 22**


Kur ndodhin rrahjen në mes nxënësve/eve <b>2019</b>	Perceptimi në mes nxënësve/eve		Perceptimi në mes profesorëve/eshave	
	raste	% në kolonë	raste	% në kolonë
1. Kur humben orë	58	15	12	14
2. Gjatë pushimeve	167	42	40	48
3. Në mes ndërrimeve	116	29	30	36.
4. Kur vihet (vijnë) në shkollë	70	18	15	18
5. Kur kthehemi (kthehen) nga shkolla	205	52	31	37
6. Gjatë orëve	28	7	3	4
7. Tjetër	22	6	5	6
Gjithsej	398	167	83	163

Përndryshe, në lidhje me të gjitha mundësitë e tjera, ndryshimet në perceptimet në mes profesorëve/eshave janë plotësisht të barabarta ose në mes tyre ekziston një dallim minimal simbolik. Kjo ngjashmëri e lartë e perceptimeve tregon se profesorët/eshat në mënyrë mjaft precize e njohin probabilitetin e momenteve të rrezikshme kur ndodhin rrahjet në mes nxënësve. Analiza e thelluar tregon se me këtë prblem më mirë janë të njohtuar profesorët/eshat të cilët janë pjesë e Programit për arsim paqësor i cili implementohet në bashkëpunim me Ambasadën e parë të fëmijëve në botë - Megjashi, për dallim prej profesorëve/eshave të cilët nuk janë pjesë e këtij programi. Profesorët/eshat që janë pjesë e Arsimit paqësor vlerësojnë se 49% e rrahjeve ndodhin kur nxënësit kthehen nga shkolla (52% e nxënësve janë përgjigjur kështu) ndërsa 22% për këtë janë përgjigjur profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e programit. Ngjashëm në atë, për rrahjet gjatë pushimeve janë përgjigjur 38% e profesorëve/eshave të cilët janë pjesë e Programit ndërsa 62% ashtu janë përgjigjur profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e Programit Këto ngjashmëri të përgjigjeve në hulumtimin e vitit 2019 në mes profesorëve/eshave të cilët janë pjesë e Arsimit paqësor dhe përgjigjet e nxënësve/eve paraqesin një lloj konfirmimi se profesorët/eshat të cilët marrin pjesë në Arsimin paqësor në këtë rast konkret janë njohtuar më mirë me problemet e nxënësve/eve. Puna brenda projektit të Arsimit paqësor me gjetje të këtilla dhe të ngjashme sugjeron se bashkëpunimi në mes profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve përmirëson shanset për një betejë më efikase në përpjekjet për të zvogëluar sjelljen e dhunshme të nxënësve në shkollat e tyre.

## **7. Shkaqet për dhe qëndrimi ndaj sjelljes së dhunshme (2019)**


Që të përcaktohen shkaqet kryesore të sjelljes së dhunshme në shkolla, u parashtrua pyetje e cila mundson të zgjidhen disa arsye si përgjigje. Arsyet kryesore për sjellje të dhunshme të nxënësve të paraqitur si një top-listë e përgjigjeve të dhëna nga ata, në radhë të parë theksojnë provokimet në formën e mesazheve abuzive (62%), ndjekur nga urrejtja ose hakmarrja (54%), pastaj mbrojtja e shokut ose shoqes (46%) etj. Mesatarisht, nxënësit/et kanë dhënë nga katër përgjigje të ndryshme, që paraqet një shumëllojshmëri të shkaqeve respektivisht shkaktarët e sjelljes së dhunshme tek nxënësit/et nuk janë të vetëm një lloji.

**Grafiku 6**



Nga aspekti i shkollave që ndodhen brenda dhe jashtë Shkupit, arsyet e sjelljes së dhunshme janë me dallime të vogla respektivisht top-pesë arsyet kryesore të dhunës në Shkup janë: provokimet (61%), urrejtja ose hakmarrja (60%), mbrojtja e shokut/shoqes (46%), xhelozia (43%) dhe shoqëria e keqe (43%). Shkaqet e dhunës në qytete jashtë Shkupit janë: provokimi (63%), urrejtja ose hakmarrja (51%), xhelozia (46%), mbrojtja e shokut/shoqes (45%), vetëmbrojtja (41%).

**Grafiku 7**




Pa dallim se a bëhet fjalë për shkollë homogjene ose heterogjene, faktorët e ndikimit janë të ngjashëm, që do të thotë se këta faktorë janë dominant gjatë tërë mostrës, a me gjasë edhe tek popullata e nxënësve. Në ma të listës së shkaqeve si faktorët më të zakonshëm për sjellje të dhunshme tek nxënësit/et janë komponentat emocionale të cilat përfaqësojnë motive të brendshme ose përgjigje ndaj një situatë rreziku dhe ata janë provokim me fjalë ofenduese dhe urrejtje ose hakmarrje. Në rrënjën e këtyre tre kategorive është

keqpërdirimi i autoritetit (fuqisë) dhe është një emërues i zakonshëm i këtyre tre formave të sjelljes së dhunshme, fakt i cili duhet të merret parasysh gjatë zgjidhjes së këtyre formave të dhunës në mes nxënësve/eve. Strukturë akoma më komplekse e këtyre problemeve është se vëzhgimi i këtyre formave të sjelljes së dhunshme tregon se ekzistojnë elemente provokuese nga njëra anë të cilat shpiejnë drejt një reagimi të dhunshëm nga ana tjetër në konfliktet e nxënësve/eve. Të tre aspektet duhet të përfshihen në Programin për arsim paqësor respektivisht nxënësit/et duhet të mësojnë se si të shmangin keqpërdorimin ndjenjës të fuqisë, si të shmangin provokimin ose reagimin e dhunshëm ndaj provokimeve.

Profesorët/eshat në shkollat, nga ana tjetër, janë me pikëpamje diçka më të ndryshme në lidhje me shkaqet kryesore të dhunës se sa provokimet (59%). Ata konsiderojnë se shkaqet kryesore të dhunës në vijim janë ndikimi i shoqërisë (38%), mbrojtja e një shokut/shoqes (37%), personaliteti i nxënësit/es (34%) dhe xhelozia (34%), ndërsa diku ndër arsyt e fundit kanë theksuar urrejtjen dhe hakmarrjen (25%). Në bazë të hulumtimit, rezultatet të cilat bazohen në ndryshimet e perceptimeve të profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve krijojnë hapësirë për ta përqëndruar vëmendjen në këto dallime ndërsa arsyt të zbulohen përmes debateve. Rezultatet kontribuojnë për të identifikuar perceptimet e ndryshme të konfigurimit të faktorëve të sjelljes së dhunshme që mundëson përmes diskutimeve në grupe të punës të nxjerrin në pah shkaqet dhe të përballen në çdo mjedis në mënyrë specifike (të veçantë). Kjo do të shpiejë deri tek afrimi i mendimeve të profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve, gjë që do të kontribuojë për mirëkuptim të ndërsjellë. Por, çdoherë në analizën e fenomeneve të këtilla, siç është bullingu, duhet të mbahet llogari edhe për mekanizmat mbrojtës të dimensioneve të pavetëdijshme-psikologjike të problemit të dhunës. Konkretisht, në disa raste tregon se një numër i caktuar i profesorëve/eshave nuk i kuptojnë plotësisht shkaqet e vërteta të këtyre formave të dhunës dhe për këtë arsye gjejnë racionalizimet dhe intelektualizimet e tyre për të gjetur kuptimin dhe shpjegimin e tyre për format e dhunës me të cilat përballen në shkolla. Prandaj edhe në këtë rast duhet të theksohet se kontributi i psikologëve shkollor në zbatimin e Programit të arsimit paqësor është i pazëvendësueshëm.

**Grafiku 8**



***Reagimet e nxënësve/eve gjatë ballafaqimit me dhunë ndaj nxënësve/eve të tjerë (2019)***

Nxënësit/et në përqindje më të lartë (42%) gjatë ballafaqimit me dhunën e mbrojnë viktimën, pa dallim a janë nga shkolla me strukturë homogjene ose heterogjene. Ky raport mund të ketë konotacion pozitiv për shkak se nxënësit/et tregojnë solidaritet me viktimën e dhunës dhe përpiqen ta ndihmojnë atë. Nëse rezultati i kësaj “përfshirje e palës së tretë” sjell deri tek qetësimi i situatës, ajo kontribuon në krijimin e

atmosferës pozitive në mjedisin në të cilin ka ndodhur ngjarja. Reagimi tjetër është të raportojnë incidentin tek profesorët/eshat kujdestarë/e (36%) ndërsa në mënyrë indiferente ndaj situatave të tilla sillen (21%) prej nxënësve/eve. Gjashtë nga të gjithë nxënësit/et e anketuar thonë se i inkurajojnë dhunuesit ndërsa një nxënës/e është deklaruar se ai/ajo iu bashkohet atyre. Fakti që mesatarisht çdo nxënës/e i/e pestë sillet indiferent në situata të tilla sinjalizon se një numër i konsiderueshëm i nxënësve/eve sillen në mënyrë pasive në situata të tilla, duke krijuar hapësirë për një manifestim të lirë të sjelljes së dhunshme. Edhe pse numri i nxënësve/eve të cilët i përkrahin dhunuesit është numër i vogël megjithatë është tregues se sjellja e tillë krijon një atmosferë të nxitjes së dhunës në mes nxënësve/eve.

Të dhënat thyejnë mitin e stereotipit se nxënëset më pak manifestojnë sjellje agresive, respektivisht, rezultatet tregojnë se shprehja e agresionit tek gjinitë është e barabartë. Megjithëse përqindja e atyre të cilët potencialisht i dëmtojnë viktimat është e ulët, ekziston një klimë zhgënjimi dhe agresioni tek ata nxënës/e.

Në fakt, pothuajse çdo i dyti nxënës/e është i gatshëm/e ta mbrojë viktimën. Në shkollat homogjene dhe heterogjene, ndryshime paraqiten në drejtim të reagimeve kur bëhet fjalë për raportimin e dhunës së ndodhur tek profesori kujdestar, respektivisht në shkollat socio-demografike homogjene në përqindje më të ulët paraqiten dhunat tek profesorët/eshat kujdestarë (28%) ndërsa në përqindje të afërt nuk ndërmerret asgjë, respektivisht nxënësi/sja tregon mosinteresim të reagojë si përgjigje se ajo nuk është puna e tij/saj (26%). Nga ana tjetër, për dallim të shkollave homogjene, në shkollat e llojit heterogjen nxënësit në përqindje më të lartë e paraqesin problemin tek profesor/esha kujdestar/e (40%) derisa në përqindje më të ulët nuk ndërmarrin asgjë (17%) me supozimin se nxënësit/et në shkollat heterogjene ballafaqohen me dhunë më të shpeshtë dhe veçse tregojnë gadishmëri për të reaguar.

**Tabela 23**

Kur e shoh ose vërej se nxënës tjerë janë të dhunshëm ndaj ndënjë shokut të klasës/shkollës, unë:		Shkolla (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkolla M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkollat A (vetëm Shqiptarë)		Shkolla M+ (Maqedonas dhe tjerë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	E mbroj viktimën	70	44	99	41	169	42
	Paraqes tek profesori kujdestar	45	28	97	40	142	36
	Nuk bëj asgjë, vetëm vëzhgoj, nuk ka të bëjë me mua	41	26	41	17	82	21
	I përkrah dhunuesit	1	1	5	2	6	2
	Iu bashkangjitem dhunuesve	1	1			1	0
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%

Në shkollat brenda dhe jashtë Shkupit, reagimet e nxënësve dallojnë. Në shkollat në Shkup, është më i vogël numri i nxënësve të cilët deklarojnë se në një situatë të tillë e mbrojnë nxënësin/en i/e cili/a është sulmuar (39%) krahasuar me shumicën e nxënësve/eve në shkollat jashtë Shkupit të cilët mbrojnë viktimën (44%) në llogari të shumicës së nxënësve/eve në Shkup të cilët nuk ndërmarrin ndonjë veprim në situata të tilla, reagimi indolent i nxënësve/eve jashtë Shkupit është më pak i shprehur (18%). Përderisa raportimi tek profesori kujdestar është pothuajse identikisht i pranishëm në Shkup dhe jashtë Shkupit (36%; 35%). Kjo seri e të dhënave tregon se në shkolla ka akoma hapësirë të punohet në procedura, sepse vetëm një e treta e nxënësve/eve raportojnë tek profesori/esha në detyrë. Këto të dhëna tregojnë së paku dy gjëra:

- ose nxënësit/et nuk besojnë se profesorët/eshat mund të ndërmarrin diçka
- ose është rezultat e përvojës së tyre se profesorët/eshat ndërmarrin diçka.

**Tabela 24**

. Kur e shoh ose vërej se nxënës/e tjerë janë të dhunshëm ndaj ndonjë shoku/shoqe të klasës/shkollës, unë:		Shkolla në Shk dhe shkolla jashtë Shk				Gjithsej	
		1 Shkolla në Shkup		2 Shkolla jashtë Shkupit		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	1 E mbroj viktimën	60	39	109	44	169	42
	2 Paraqes tek profesori kujdestar	55	36	87	35	142	36
	3 Nuk bëj asgjë, vetëm vëzhgoj, nuk ka të bëjë me mua	37	24	45	18	82	20
	4 I përkrah dhunuesit	1	1	5	2	6	2
	5 Iu bashkangjitem dhunuesve	1	1			1	0
Gjithsej		154	100%	246	100%	400	100%

**Reagimet e profesorëve/eshave gjatë ballafaqimit me dhunën ndaj nxënësve tjerë (2019)**

Profesorët/eshat, në pyetjen “Kur ju raportohet për rast dhune ndaj një nxënësi, çfarë ndërmerrni? -”, në përqindje më të lartë japin përgjigjen se do të ndërmarrin masa të caktuara në bashkëpunim me shkollën (95%). Kjo përgjigje konsensuale e profesorëve/eshave ndoshta në numër të caktuar të rasteve paraqet përgjigje të dëshirueshme sociale. Nga aspekti metodologjik paraqet problem që nuk ekziston mundësi përmes një anketimi të përcaktohet se në çfarë proporcioni janë përgjigjet e tilla të dëshirueshme sociale në krahasim me proporcionin me përgjigjet “reale”. Për të hyrë më thellë në këtë fenomen, duhet të studiohet më tej duke përdorur disa nga metodat cilësore siç janë intervistat e thelluara (In Depth) ose të organizohen diskutime në grup (fokus grupe).

Mirëpo paraqitet një përqindje e ulët e profesorëve/eshave prej 5% që nuk duhet anashkaluar dhe që tregon faktin se profesorët/eshat kanë rezistencë ndaj ofrimit të ndihmës për nxënësit/et të cilët janë në telashe të mundshme. Më saktë bëhet fjalë për 4 nga profesorët/eshat, njëri prej të cilëve nuk do të ndërmarrë asgjë (dhe është pjesë e Arsimit paqësor), njëri nuk do t’u besojë nxënësve/eve, njëri prej tyre do t’i drejtohet rrjeteve sociale dhe mediave ndërsa një do të reagojë pas që të raportohet rasti nga një grup nxënësish/esh. Me përjashtim të individëve, profesorët/eshat kryesisht deklarojnë se ndërmarrin masa përkatëse për ta zgjidhur dhunën. Është e nevojshme inkuadrimi i Arsimit paqësor në shkolla dhe trajnim për të gjithë profesorët/eshat për parimet dhe masat që duhet të merren në rast të incidenteve të ndryshme në shkolla dhe në këtë mënyrë profesorët/eshat do të kenë pjesë të rolit në parandalimin dhe shuarjen e dhunës potenciale si dhe zgjidhjen e zhvillimeve aktuale në shkolla.

**Grafiku 9**



## Frigo nga dhuna (2019)

Tre nga katër nxënës/e (75%) nuk kanë frikë se do të përjetojnë dhunë nga ana e nxënësve/eve tjerë në shkollë, 21% thonë se ata rrallë ndjehen të frikësuar, ndërsa shpesh ndjehen të frikësuar 3% dhe gjithmonë të frikësuar janë 4 nxënës ose 1% nga të gjithë të anketuarit. Ndjenja e sigurisë do t'u mundësojë nxënësve/eve më pak frikë dhe stres, si dhe komunikim më të mirë me nxënësit/et tjerë ndërsa veçanërisht besimi i madh tek profesorët/eshat do të mundësojë zhvillimin e tyre më të mirë mendor dhe fizik. Nëse nxënësit/et jetojnë në frikë se do të jenë të sulmuar qoftë në mënyrë psikologjike ose fizike, ata kanë potencialin për t'u bërë të dhunshëm. Ky problem me dhunën është dykahës, sepse viktimat shpesh bëhen të dhunshëm (dhunues) dhe për këtë arsye është e nevojshme të flitet hapur për këto probleme.

Nga aspekti i asaj se a ka incidente ndëretnike në shkollë, vërehet një fotografi racionale ku ata nxënës/e të cilët/at asnjëherë nuk kanë frikë se do të sulmohen nga nxënës/e të grupeve të tjera etnike, janë edhe në një përqindje pak më të ulët të përfaqësuar incidentet në shkolla (72% ka incidente, 78% nuk ka incidente).

**Tabela 25**

Frigoem se nxënësit e shkollës time do të jenë të dhunshëm ndaj meje:		A konsideron se ka ose nuk ka incidente ndëretnike në shkollën tënde?				Gjithsej	
		Po, ka		Jo, nuk ka		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Asnjëherë	146	72	153	78	299	75
	Rrallë	47	23	38	19	85	21
	Shpesh	7	3	5	3	12	3
	Çdoherë	3	1	1	1	4	1
	Gjithsej	203	100%	197	100%	400	100%

Analiza e thelluar për sa i përket asaj se a ka pasur rrahje në shkollë, tregoi se tek rreth 55% prej nxënësve/eve të cilët asnjëherë nuk frikësohen se nxënësit/et e shkollës do të jenë të dhunshëm ndaj tyre janë përgjigjur me “shumë rrallë” ose “asnjëherë” se ka pasur rrahje në shkollë. Nga aspekti i homogjenitetit ose heterogjenitetit të shkollave, si dhe pozitës së shkollës e cila mund të jetë brenda ose jashtë Shkupit, nuk ka dallime në përgjigjet e nxënësve të cilët ndjejnë ose nuk ndjejnë frikë se mund të jenë viktimat e dhunës. Kjo tregon për faktin se frika e dhunës është po aq e përhapur në shkolla, pa dallim nga përbërja nacionale ose vendndodhja e shkollës.

## Reagimet tek nxënësit/et gjatë përjetimit të dhunës (2019)

Edhe pse i parëndësishëm, vërehet dallimi ndërmjet nxënësve/eve për sa i përket faktit nëse ata vijnë nga shkolla homogjene ose heterogjene dhe nëse hakmerren në të njëjtën mënyrë kur përjetojnë dhunë. Respektivisht, nxënësit/et nga shkollat homogjene në një shkollë më të lartë reagojnë ndaj dhunës në mënyrë që përgjigjen me të njëjtën (30%) ndërsa nxënësit/et nga shkollat heterogjene reagojnë një nivel më të ulët me dhunë (22%). Gjithashtu, nxënësit nga shkollat me strukturë homogjene të nxënësve/eve në nivel pak më të ulët nuk kanë qenë viktimat e dhunës (35%) se sa nxënësit/et nga të përzierat, respektivisht strukturat heterogjene (42%), që mund të jetë shenjë se nxënës/e të caktuar ose grupe të nxënësve/eve janë të dhunshëm respektivisht viktimat e dhunës nga nxënës/e të përkatësive tjera etnike.



**Tabela 26**

Si vepron kur dikush është i/e dhunshëm nfaj teje?:		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Kthej në të njëjtën mënyrë	47	30	53	22	100	25
	Kërkoj ndihmë nga të rriturit	17	11	22	9	39	10
	Nuk i kushtoj rëndësi, njësoj e kam	31	20	49	20	80	20
	Iki (largohem)	2	1	7	3	9	2
	Nuk kam qenë viktimë e dhunës	55	35	101	42	156	39
	Pa përgjigje	6	4	10	4	16	4
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%


Në një varg parametrash shohim se rezultatet e përgjigjeve të nxënësve/eve të cilët jetojnë në ose jashtë kryeqytetit janë shumë të afërta, që nuk çon në një përfundim të mundshëm se situata në shkollat e Shkupit është në të njëjtin nivel me shkollat jashtë qytetit dhe se dhuna kryesisht është përhapur njëjtë kudo, se viktimat dhe reagimet tek nxënësit/et ndaj dhunës manifestohen në mënyrë të ngjashme.

## 8. Masat për përmirësimin e mirëkuptimit në mes nxënësve/eve prej grupeve të ndryshme etnike (2019)

### *Përgjigjet e nxënësve/eve*

Për ta kuptuar më mirë mendimin e nxënësve/eve, e parashtruam pyetjen e hapur “Sipas jush çka duhet të bëhet për të përmirësuar mirëkuptimin në mes nxënësve/eve të grupeve të ndryshme etnike në shkollën tuaj?”, ndërsa ata dhanë kahje të caktuara duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje në mënyrë spontane. Përkatësisht, në përqindje më të lartë, nxënësit/et besojnë se realizimi i orëve të përbashkëta, punëtorive, projekteve dhe aktiviteteve do t’i përmirësonte në masë më të madhe marrëdhëniet ndëretnike (28%). Më tutje, respektimi i grupeve të ndryshme etnike si dhe bashkëpunimi dhe mirëkuptimi i ndërsjellë është në vendin e dytë dhe gjendet në 14% të përgjigjeve, ndërsa në vendin e tretë theksohet komunikimi ndëretnik në mes nxënësve/eve, profesorëve/eshave, psikologëve (8%). Nxënësit/et janë përgjigjur me një varietet të madh përgjigjesh, që tregon se ata janë të gatshëm të bëjnë ndryshime të caktuara sa i përket marrëdhënieve ndëretnike.

Grafiku 10



Vetëm tek një grup i vogël i nxënësve/eve prej shtatë nxënësve/eve vërehen forma të caktuara të intolerancës ndëretnike, ku kryesisht nxënësit/et tregojnë pakënaqësi dhe mosinteresim për zgjidhjen e marrëdhënieve ndëretnike. Ndërsa dy nxënës/e tregojnë zhgënjim se nuk ka mënyra për zgjidhjen këtyre probleme, respektivisht ata thonë se mirëkuptimi nuk do të përmirësohet. Nga ana tjetër, rreth 7% e nxënësve/eve janë të kënaqur me situatën respektivisht ata besojnë se nuk ka probleme sa i përket mirëkuptimit ndëretnik.

Në analizën e përgjigjeve të kryqëzuara, vërejmë ndryshim në përgjigjet në mes nxënësve/eve nga mjediset homogjene dhe heterogjene tek përgjigjeja në lidhje me realizimin e orëve të përbashkëta, punëtorive, projekteve dhe aktiviteteve edhe atë si propozim në shkollë më të lartë këtë e japin nxënësit/et nga mjediset heterogjene (33%) sesa nxënësit/et nga mjediset homogjene (20%). E ngjashme është situata në lidhje me këtë përgjigje tek nxënësit/et në Shkup dhe jashtë Shkupit, përkatësisht nxënësit/et në Shkup në një përqindje më të ulët (20%) e sugjerojnë këtë mënyrë për përmirësimin e mirëkuptimit në për dallim prej nxënësve/eve të cilët jetojnë jashtë Shkupit (33%).

## Përgjigjet e profesorëve/eshave (2019)

Profesorët/eshat në pyetjen “Sipas jush çka duhet të bëhet që të përmirësohet mirëkuptimi në mes profesorëve/shave të grupeve të ndryshme etnike në shkollë?”, kryesisht përgjigjen se nevojiten aktivitetet e lira (jashtë orëve) (31%) ndërsa një përqindje e madhe e tyre nuk japin përgjigje për të përmirësuar mirëkuptimet ndëretnike (29%).

Grafiku 11



Kryesisht profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e Arsimit paqësor në përqindje më të lartë nuk japin përgjigje (38%) se sa profesorët/eshat të cilët janë pjesë e Arsimit paqësor (19%) që në një farë mase tregojnë dobinë dhe përfitimet e Arsimit paqësor si bazë për ide dhe mënyra të ballafaqimit në mes profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve nga bashkësitë të tjera etnike.

## 9. Viktimat e dhunës (2011 – 2019)

### *Dallimet në perceptim të viktimave të dhunës në shkollat e mesme*

Perceptimi i viktimave të dhunës në vitin 2019, për dallim nga vitet e kaluara, është i pandryshuar në aspektin e strukturës së shkollave në bazë të homogjenitetit ose heterogjenitetit. Respektivisht, pothuajse e njëjta përqindje e nxënësve/eve përgjigjen se ata janë personalisht viktimat të dhunës në shkollat homogjene (11%) dhe heterogjene (10%), si dhe se shokët/shoqet e tjerë të klasës janë viktimat të dhunës (nga 82% në të dy strukturat). Në vitet e mëparshme, vërehen dallime në aspektin e shkollave homogjene dhe heterogjene, edhe atë në vitin 2011, 81% e nxënësve/eve thuanë se shokët/shoqet e tjerë të klasës janë viktimat ndërsa 3% ishin vetë ata viktimat, ndërsa në heterogjenet janë 92% deri në 5%. Në vitin 2012, në shkollat homogjene 70% e viktimave janë shokë/shoqe të tjerë të klasës dhe 5% ishin vetë ata, ndërsa në shkollat heterogjene 88% ishin shokë/shoqe të tjerë të klasës ndërsa 3% ishin nxënësit/et të cilët u përgjigjen. Në fakt, vërehet një trend i barazimit të dhunës dhe viktimave në vitin 2019 në krahasim me shkollat homogjene dhe heterogjene për dallim prej viteve tjera. Gjithashtu, numri i viktimave të dhunës në vitin 2019 është rritur në krahasim me vitet e kaluara, respektivisht viktimat janë vetë ata por edhe shokët/shoqet e tyre të klasës. Në matjen e fundit tek shkollat homogjene, përqindja e shkollave në të cilat nuk ka dhunë është përgjysmuar në krahasim me vitet e kaluara (15% në 2019, 30% në 2012 dhe 36% në 2011, shiko Tabelën 27).

**Tabela 27**

A ke qenë t'i ose dikush nga shokët/shoqet e tu/aja të klasës viktimat të dhunës në shkollën tënde (janë të mundshme më shumë përgjigje)		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2011	Unë	5	3%	12	5%	17	5%
	Shokë/shoqe tjetër	95	64%	205	92%	300	81%
	Nuk ka dhunë në shkollë	53	36%	15	7%	68	18%
	Gjithsej <sup>16)</sup>	148	103%	222	104%	370	104%
2012	Unë	7	5%	6	3%	13	4%
	Shokë/shoqe tjetër	97	70%	164	88%	261	80%
	Nuk ka dhunë në shkollë	41	30%	18	10%	59	18%
	Gjithsej	139	103%	186	104%	325	104%
2019	Unë	17	11%	24	10%	41	10%
	Shokë/shoqe tjetër	129	82%	198	82%	327	82%
	Nuk ka dhunë në shkollë	24	15%	33	14%	57	14%
	Gjithsej	158	108%	242	105%	400	106%

Testimet se a ka dallime në përgjigjet e nxënësve në shkollat e mesme brenda dhe jashtë Shkupit tregojnë se praktikisht në numër të barabartë ata deklarojnë se nuk ka dhunë në shkollat e tyre (13% në Shkup dhe 15% jashtë Shkupit).

<sup>16)</sup> Në këtë pyetje të anketuarit kishin mundësinë të japin më shumë se një përgjigje. Në totalin është i paraqitur numri i nxënësve/eve të anketuar ndërsa në përqindjet është paraqitur përgjigjja totale e përgjigjeve të dhëna.

**Tabela 28**

A ke qenë t'i ose dikush nga shokët/ shoqet tuaja të klasës viktimë të dhunës në shkollën tënde (janë të mundshme më shumë përgjigje)		Shkolla brenda dhe jashtë Shkupit				Gjithsej	
		Shkolla në Shkup		Shkolla jashtë Shkupit		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Unë	11	7	30	12	41	10
	Shokë/shoqe tjetër	131	85	196	80	327	82
	Nuk ka dhunë në shkollë	20	13	37	15	57	14
	Gjithsej	154	105%	246	107%	400	106%

***Viktima të dhunës të kategorive të ndryshme***

Nxënësit të cilët kanë përjetuar të jenë të maltretuar në përqindje më të lartë janë viktimë të shokëve të klasës / moshatarëve (20%) ndërsa në përqindje shumë më të ulëta janë viktimë të nxënësve më të vjetër (8%), nxënësve më të rinj (2%) ose të rriturve (3%). Nga të gjithë të anketuarit, 65% thonë se nuk kanë qenë viktimë të dhunës dhe 3% nuk japin përgjigjen në këtë pyetje. Nuk ka ndonjë dallim domethënës në mes kategorive përsa i përket faktit nëse nxënësit janë nga shkolla homogjene ose heterogjene, por dhuna inklinon (bjen mundësia) të ndodhë më shumë në shkollat homogjene (62% - nuk kanë qenë viktimë të dhunës) përkundrajt shkollave heterogjene (67%), shiko Tabelën 29.

**Tabela 29**

Nëse ndonjëherë ke qenë viktimë e dhunës, prej kujt ke përjetuar të jesh i/e maltretuar?		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Magedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Epoj	Kol %
		Epoj	Kol %	Epoj	Kol %		
2019	Moshatarë	29	18	51	21	80	20
	Nxënës më të vjetër	20	13	12	5	32	8
	Nxënës më të rinj	3	2	3	1	6	2
	Të rriturit	3	2	8	3	11	3
	Nuk kam qenë viktimë e dhunës	98	62	161	67	259	65
	Pa përgjigje	5	3	7	3	12	3
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%

***Dallimet në perceptimin e “shënjestrës” (targetit) të dhunës në shkollat e mesme të caktuara nga shkalla e homogjenitetit etnik (2011 - 2019)***

Observimi analitik i Tabelës 30 tregon se ka dallime më të theksuara në përgjigjet “më shpesh se sa nxënësit prej grupeve tjera etnike” tek shkollat heterogjene në vitin 2011 (4%), 2012 (9%) dhe 2019 (20%). Dallime të ngjashme vërejmë në përgjigjen se nxënës prej grupeve tjera etnike në shkollë nuk janë viktimë të dhunës në shkolla homogjene edhe atë nga 60% në vitin 2011, në 64% në 2012 dhe rënie prej 23% pikë përqindje në krahasim me anketën në vitin 2019 (41%) që përputhet me shqyrtimet e mëparshme të rezultateve ku vërejmë një rritje të përgjithshme të dhunës në shkollat homogjene krahasuar me vitet e kaluara. Ekziston mundësia që pikëpamjet e tilla të jenë formuar në bazë të perceptimit social në publik (opinion), ku në fillim të dekadës së kaluar (2011/2012) dominonin qëndrime më të forta nacionaliste që ndikonin drejtpërdrejt në qëndrimet e nxënësve.

**Tabela 30**

Sa shpesh nxënësit/et e grupit tënd etnik janë viktima të dhunës në krahasim me nxënësit/et e grupeve tjera etnike?		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2011	Më shpesh se sa nxënësit e grupeve tjera etnike	6	4%	39	18%	45	12%
	Në masë të njëjtë si dhe nxënësit e grupeve tjera etnike	31	21%	73	33%	104	28%
	Më rrallë se nxënësit e grupeve tjera etnike	22	15%	60	27%	82	22%
	Nxënësit e grupeve tjera etnike në shkollën time nuk janë viktima të dhunës	89	60%	48	22%	137	37%
	Nuk e di			2	1%	2	1%
	Gjithsej	148	100%	222	100%	370	100%
2012	Më shpesh se sa nxënësit e grupeve tjera etnike	12	9%	34	18%	46	14%
	Në masë të njëjtë si dhe nxënësit e grupeve tjera etnike	29	21%	68	37%	97	30%
	Më rrallë se nxënësit e grupeve tjera etnike	9	7%	45	24%	54	17%
	Nxënësit e grupeve tjera etnike në shkollën time nuk janë viktima të dhunës	89	64%	39	21%	128	39%
	Gjithsej	139	100%	186	100%	325	100%
2019	Më shpesh se sa nxënësit e grupeve tjera etnike	32	20%	47	19%	79	20%
	Në masë të njëjtë si dhe nxënësit e grupeve tjera etnike	40	25%	67	28%	107	27%
	Më rrallë se nxënësit e grupeve tjera etnike	22	14%	53	22%	75	19%
	Nxënësit e grupeve tjera etnike në shkollën time nuk janë viktima të dhunës	64	41%	75	31%	139	35%
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%

***Përkrahja dhe kujdesi ndaj nxënësve të ekspozuar në dhunë nga ana e profesorëve/eshave (2019)***

Kur i pyetëm profesorët/eshat në lidhje me angazhimin e shkollës (stafit mësimor ose shërbimeve profesionale) në lidhje me përkrahjen që ju jepet nxënësve të cilët janë të ekspozuar ndaj dhunës, në përqindje më të lartë profesorët/eshat nga shkollat homogjene thonë se nxënësve/eve iu jepet përkrahje gjithmonë, për dallim prej profesorëve/eshave nga shkollat heterogjene të cilët konsiderojnë se ajo përkrahje jepet më rrallë. Përkatësisht, 60% prej profesorëve/eshave nga shkollat homogjene thonë se përkrahja jepet gjithmonë, ndërsa 46% e profesorëve/eshave nga shkollat heterogjene e konsiderojnë atë (shiko Tabela 31). Përgjigjet e grumbulluara shpesh, rrallë dhe asnjëherë tregojnë se gjithashtu ekzistojnë edhe dallime në përgjigjet e profesorëve/eshave, respektivisht profesorët/eshat nga shkollat homogjene 40% i japin këto përgjigje për dallim prej profesorëve/eshave nga shkollat heterogjene të cilët 54% kanë dhënë përgjigje të tilla. Nuk mund të anashkalohen të dhënat të cilat tregojnë se dy profesorë/eshat nga shkollat heterogjene thonë se asnjëherë nuk i jepet përkrahje dhe kujdes nxënësit të ekspozuar ndaj dhunës. Këtu është shumë e rëndësishme të theksohet se nxënësve duhet t'u kushtohet vëmendje e njëjtë si atyre të cilët janë të ekspozuar ndaj dhunës, ashtu edhe ndaj nxënësve/eve të cilët janë sjellur në mënyrë të dhunshme.

**Tabela 31**

Sa shpesh shkolla (stafi mësimor, shërbimet profesionale) u jep përkrahje dhe kujdes nxënësve të cilët janë të ekspozuar ndaj dhunës?		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Çdoherë	18	60	26	46	44	51
	Shpesh	9	30	19	34	28	33
	Rrallë	3	10	8	14	11	13
	Asnjëherë			2	4	2	2
	Pa përgjigje			1	2	1	1
	Gjithsej	30	100%	56	100%	86	100%

## 10. Masat të cilat duhet të ndërmerren ndaj dhunuesve në shkolla (2019)

Ashtu si në pyetjen e mëparshme, edhe në përgjigjet e kësaj pyetje vërejmë tendencë që profesorët/eshat në shkollat heterogjene të tregojnë rezistencë më të madhe në luftën kundër bullingut respektivisht ata kanë një tendencë më të theksuar për sanksionimin e dhunuesve (32%) se sa nxënësit nga shkollat heterogjene të cilët konsiderojnë se me anë të parandalimit do të mund të ndihmoet, si dhe të tregohet kujdes ndaj dhunuesit për ta përmirësuar shëndetin e tij mendor (45%). Lidhur me këtë, raporti në mes nxënësve nga shkolla homogjene dhe heterogjene të cilët mendojnë se dhunuesit duhet të ndihmohen është 35%: 45%, ndërsa raporti në mes profesorëve/eshave është 73%: 55%. Nga ana tjetër, profesorët/eshat nga shkollat heterogjene (32%) dhe nxënësit/et nga shkolla homogjene (58%) në përqindje më të lartë besojnë se dhunuesi duhet të ndëshkohet për dallim prej profesorëve/eshave nga shkollat homogjene (13%) dhe nxënësit/et nga shkollat heterogjene (43%).

**Tabela 32**

Sipas mendimit tuaj, si duhet të veprohet ndaj dhunuesit?: 2019		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Epoj	Kol %
		Epoj	Kol %	Epoj	Kol %		
<b>Nxënësit/et</b>	T'i ndihmohet	55	35	110	45	165	41
	Të ndëshkohet	92	58	103	43	195	49
	Të injorohet	2	1	14	6	16	4
	Të ndryshohet shoqëria	1	1			1	0
	Përrjashtim nga shkolla	7	4	13	5	20	5
	Të drejtohet në psikolog	1	1	2	1	3	1
	<b>Gjithsej</b>	<b>158</b>	<b>100%</b>	<b>242</b>	<b>100%</b>	<b>400</b>	<b>100%</b>
<b>Profesorët/eshat</b>	T'i ndihmohet	22	73	31	55	53	62
	Të ndëshkohet	4	13	18	32	22	26
	Të injorohet			1	2	1	1
	Të ndëgjohen shkaqe dhe pastaj të reagohet në menyrë përkatëse	3	10	6	11	9	10
	Pa përgjigje	1	3			1	1
	<b>Gjithsej</b>	<b>30</b>	<b>100%</b>	<b>56</b>	<b>100%</b>	<b>86</b>	<b>100%</b>

Nëse observohen me kujdes variacionet në përgjigjet e profesorëve/eshave dhe nxënësve/eve, mund të shihet se ekziston një prirje e qartë në mes nxënësve/eve, pavarësisht nëse janë nga shkolla homogjene ose heterogjene, që në numër më të madh të shprehen për masa ndëshkuese restriktive për dallim nga qëndrimi i profesorëve/eshave. Kjo mund të jetë rezultat i tolerancës së ulur ndaj dhunuesit që shpjen drejt besimit të zvogluar ndaj parandalimit të dhunës. Këto të dhëna ndoshta hedhin më shumë dritë mbi nevojën më të theksuar për ndërmarrjen e masave restriktive në kuadër të Programit për arsim paqësor për të vendosur më shumë theks në nevojën për t'iu ofruar ndihmë të përshtatshme dhunuesve, të studjohen shkaqet e sjelljes së dhunshme, sepse një qasje e tillë ofron mundësi për arritjen e rezultateve të qëndrueshme në luftën kundër dhunës në shkollë. Kontribut i dytë i rëndësishëm i kësaj qasjeje është se edukimi i nxënësve/eve për të marrë përgjegjësinë për kontrollin e sjelljes do të rrisë njohjen për tejkalimin e nevojës për një “dorë të fortë” prezente në sistemet shoqërore autoritare.

Prej këtu edhe del rekomandimi për Arsimin paqësor që të punojë vazhdimisht në marrjen e përgjegjësisë për sjelljen edhe të profesorëve/eshave edhe të nxënësve/eve. Në kuadër të Programit të stimulohet një përfshirje më e madhe e nxënësve/eve në zhvillimin e procedurave për ballafaqimin me dhunë.

## **11. Arsyetimi i përdorimit të dhunës në zgjidhjen e problemeve në shoqëri (2011 - 2019)**

Gati dy të tretat e nxënësve në vitin 2019 konsiderojnë se nuk është e justifikuar zgjidhja e problemeve në shoqëri me anë të dhunës që në krahasim me vitin 2012 është në rënie prej rreth 9% pikë përqindje, që deri diku tregon një trend të rritjes së intolerancës dhe zgjidhjes së dhunshme të problemeve. Diçka më të larta janë përqindjet e nxënësve nga mjediset homogjene në të cilat mësojnë vetëm Shqiptarë/e (34%) në krahasim me grupet e tjera (shkolla homogjene me Maqedonas/e (27%) dhe grupe tjera etnike dhe shkollat heterogjene (29%).



**Tabela 33**

A konsideroni se përdorimi i dhunës për të zgjidhur problemet në shoqëri është e arsyeshme ose e paarsyeshme		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)						Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë)		Shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	E arsyeshme (tërësisht + deri diku)	28	27	18	34	70	29	116	29
	E paarsyeshme (tërësisht + deri diku)	77	73	35	66	172	71	284	71
	Gjithsej	105	100%	53	100%	242	100%	400	100%

Klima e këtillë e ndryshme e përcaktuar nga prania e dhunës në shkolla ka kontribuar të formohen edhe pikëpamje të ndryshme mbi arsyetimin e dhunës. Në shkollat me përbërje socio-demografike homogjene, 15% në 2011, 17% në 2012 dhe 29% në 2019 e konsiderojnë dhunën si të arsyeshme, përkundrejt 33% në 2011 që zbriti për 10 pikë përqindje dhe në 2012 ishte 23% ndërsa përsëri u rrit me 6 pikë përqindje në vitin 2019 (29%) në shkolla me përbërje socio-demografike heterogjene, (shiko Tabelën 34).

**Tabela 34**

A konsideroni se përdorimi i dhunës për të zgjidhur problemet në shoqëri është e arsyeshme ose e paarsyeshme?		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2011	E arsyeshme	23	<b>15%</b>	73	<b>33%</b>	96	26%
	E paarsyeshme	125	85%	149	67%	274	74%
	Gjithsej	148	100%	222	100%	370	100%
2012	E arsyeshme	23	<b>17%</b>	42	<b>23%</b>	65	20%
	E paarsyeshme	116	84%	144	77%	260	80%
	Gjithsej	139	100%	186	100%	325	100%
2019	E arsyeshme	46	<b>29%</b>	70	<b>29%</b>	116	29%
	E paarsyeshme	112	71%	172	71%	284	71%
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%

Në përgjithësi, vërehet një trend i rritjes së pranimit të arsyetimit të zgjidhjes së problemeve në shoqëri përmes dhunës. Ky konstatim korrespondon me realitetin shoqëror në vend, sepse në dekadën e fundit në opinionin publik ekziston një perceptim i pandëshkueshmërisë për dhunën, e cila nga një anë tjetër dërgon një mesazh se nuk ka mekanizma të tjerë për zgjidhjen e konflikteve përveç dhunës.

Tek nxënësit të cilët jetojnë brenda dhe jashtë Shkupit, nga ana tjetër, janë detektuar dallimet në perceptimin e tyre për zgjidhjen e problemeve në shoqëri me anë të dhunës. Përkatesisht, nxënësit nga Shkupi (35%) kanë një tendencë më të madhe të përgjigjen se problemet sociale është e arsyeshme të zgjidhen me dhunë se sa nxënësit të cilët jetojnë jashtë Shkupit (25%) gjë që mbështetet nga gjetjet prej pyetjeve të tjera se perceptimet për dhunën në shkolla janë diçka më të lartë në Shkup se sa në qytetet e tjera.

## 12. Të kërkuarit e ndihmës pas përjetimit të dhunës (2019)

### Të drejtuarit tek prindërit pas përjetimit të dhunës

Për shkak të ndërlikueshmërisë të fenomenit të dhunës dhe të kuptuarit dhe pranimit të ndryshëm, si dhe perceptimit të përjetimit të dhunës, i pyesim të gjithë nxënësit/et (edhe ata të cilët kanë përjetuar edhe ata të cilët nuk kanë përjetuar dhunë) se si reagojnë ose nëse dhe sa shpesh u drejtohen prindërve të tyre. Për të bërë dallim në mes përgjigjeve të nxënësve/eve të cilët kanë deklaruar se kanë përjetuar dhunë me nxënësit/et të cilët kanë deklaruar se nuk kanë përjetuar dhunë, i kryqëzua përgjigjet lidhur me pyetjen sa shpesh dhe nëse ndonjëherë iu drejtohen prindërve të tyre. Nxënësit/et të cilët janë viktimë të dhunës në përqindje më të madhe asnjëherë nuk iu janë drejtuar prindërve të tyre (32%) se sa ata nxënës/e të cilët deklarojnë se nuk kanë qenë viktimë të dhunës dhe asnjëherë nuk iu drejtohen prindërve të tyre (10%). Respektivisht, është alarmues fakti që gati një e treta e nxënësve/eve të cilët kanë qenë viktimë të dhunës nuk u janë drejtuar prindërve të tyre për dhunën e përjetuar.

**Tabela 35**

U drejtohem prindërve nëse kam përjetuar dhunë:		Viktima të dhunës				Gjithsej	
		Viktimë e dhunës		Nuk ka qenë viktimë e dhunës		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Asnjëherë	45	32	25	10	70	18
	Rrallë	40	28	18	7	58	15
	Shpesh	8	6	4	2	12	3
	Çdoherë	36	26	22	8	58	15
	Nuk kam qenë viktimë e dhunës			190	73	190	48
	Pa përgjigje	12	9			12	3
	Gjithsej	141	100%	259	100%	400	100%

Nga të gjithë nxënësit të cilët i janë përgjigjur pyetjes: Au drejtohen prindërve të tyre kur përjetojnë ndonjë dhunë?, nuk vërejmë ndonjë dallim për sa i përket faktit nëse vijnë nga shkolla homogjene ose heterogjene dhe nëse vijnë nga Shkupi apo nga shkolla jashtë kryeqytetit. Kështu, mesatarisht, 18% e nxënësve/eve asnjëherë nuk i tregojnë prindërve të tyre dhe 15% rrallë. Me “shpesh” përgjigjen 3% e nxënësve, ndërsa me “gjithmonë” janë përgjigjur 15% prej nxënësve/eve.

**Tabela 36**

U drejtohem prindërve nëse kam përjetuar dhunë:		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Asnjëherë	28	18	42	17	70	18
	Rrallë	26	16	32	13	58	15
	Shpesh	4	3	8	3	12	3
	Çdoherë	24	15	34	14	58	15
	Nuk kam qenë viktimë e dhunës	74	47	121	50	195	49
	Pa përgjigje	2	1	5	2	7	2
	Gjithsej	158	100%	242	100%	400	100%


## Frekuenca e të drejtuarit të viktimave të dhunës në shkollë (2019)

Nxënësit/et në pyetjen lidhur me atë se kujt dhe sa shpesh drejtohen në shkollë kur janë viktimë të dhunës, në përqindjen më të lartë janë përgjigjur se ata asnjëherë nuk i drejtohen drejtorit të shkollës (62%), diçka më pak profesorit/eshës tjetër (50%), pedagogut / psikologut (42%), kujdestarit të klasës (34%), shokut / shoqes të klasës (31%). 28% të nxënësve/eve thonë se asnjëherë nuk e zgjidhin problemin vetë ndërsa vetëm 9% prej të gjithë nxënësve/eve thonë se nuk i kanë treguar askujt në shkollë kur kanë qenë viktimë të dhunës.

Gjatë grumbullimit të përgjigjeve “gjithmonë + shpesh”, vija e të drejtuarit ndaj të tjerëve, shohim një gatishmëri të caktuar të nxënësve/eve për të shprehur përvojën e tyre ose më saktë, nxënësit/et janë të gatshëm t’ia shprehin dikujt pozicionin të viktimës. Më konkretisht, në përqindjen më të lartë, nxënësit/et janë të aftë ta zgjidhin vetë problemin (55%) ose t’u tregojnë shokëve/shoqeve të tyre të klasës (49%) dhe kujdestarit të klasës (48%). Gjithsesi, këto janë situata hipotetike, respektivisht në varësi prej llojit të dhunës, nxënësi/ja mund të ndihet i/e gatshëm/e që ta zgjidhë vetë problemin, edhe pse dikush tjetër mund të njoftohet për situatën.

Si përgjigje spontane që janë dhënë tek opioni “tjetër” paraqiten disa ku nxënësit/et thonë se u drejtohen miqve / shokëve, sigurimit, policisë, nxënësve/eve më të vjetër ndërsa një përgjigje spontane nga një nxënës/e dha një reagim ekstrem ndaj dhunës ku u përgjigj “unë e vras” (në të njëjtën kohë, ky nxënës i zgjidh problemet vetë ndërsa shpesh i tregon shokut të klasës).

Grafiku 12



## Kujt, sipas profesorëve/eshave duhet t’i drejtohen nxënësit/et për ndihmë prej dhunës (2019)

Në pyetjen “Kur nxënësit përjetojnë dhunë, kujt sipas jush duhet t’i drejtohen për ndihmë?” në të cilën sipas prioritetit duhet të vendoset se kujt duhet t’i drejtohen nxënësit/et për ndihmë, profesorët/eshat përgjigjen me rangje tek çdo përgjigje. Përpunimi i përgjigjeve të këtyre pyetjeve është nëpërmjet dhënies së pikëve në çdo rang<sup>17</sup>. Sipas përgjigjeve të marra, renditja më e lartë e ka përgjigjen se nxënësit/et duhet t’i drejtohen profesorit/eshës ose kujdestarit/es të klasës, përgjigjja tjetër është se ata duhet t’i drejtohen pedagogut respektivisht psikologut të shkollës, përgjigjja - prindërve të tyre është në vendin e tretë, pastaj drejtorit, shokut/shoqes të klasës, në vendin e gjashtë është se ata duhet të telefonojnë në linjën telefonike SOS për fëmijë dhe të rinj në Megjashi, pastaj policisë, dhe përgjigje më të pakta ka përgjigjja se ata nuk duhet t’i drejtohen askujt. Është për t’u habitur fakti se një e pjesë profesorëve/eshave besojnë se nxënësit/et nuk duhet t’i drejtohen askujt për ndihmë gjatë dhunës, megjithatë është e pranishme..

Këto gjetje mbështesin faktin se një pjesë e profesorëve/eshave konsiderojnë se arsimit është detyra e tyre themelore, vetëm të japin mësim dhe të vlerësojnë (notojnë). Komponenti arsimor - për komunikimin me nxënësit/et, zgjidhjen e konflikteve, e të ngjashme konsiderojnë se nuk hyn në pjesën e detyrave të tyre

të punës. Këto janë argumente që shkojnë në drejtim të punës me profesorët/eshat zhvillimin e aftësitë të tyre për zgjidhjen e konflikteve. Kjo mungesë mund të arrihet në kuadër të Arsimit paqësor me anë të ngritjes së vetëdijes për rolin e tyre në procesin arsimor.

**Tabela 37**

Profesorit/eshës / kujdestarit të klasës:	610	1
Pedagogut / psikologut:	547	2
Prindërve:	533	3
Drejtorit:	375	4
Shokut/Shoqes të klasës:	253	5
SOS telefoni për fëmijë dhe të rinj pranë Megjashit:	178	6
Policisë:	173	7
Askujt:	52	8

### ***Nga kush kërkojnë ndihmë profesorët/eshat pas/gjatë dhunës (2019)***

Kur ndonjëri prej profesorëve/eshave është gjetur në situatë konflikti, zakonisht është drejtuar tek më kompetentët në shkollë dhe ata të cilët i konsiderojnë autoritarë si pedagogu / psikologu (73%), kujdestarë të klasave (52%) dhe drejtorë (28%). Më së paku profesorët/eshat i drejtohen policisë ose nuk i drejtohen askujt.

Profesorët/eshat të cilët janë në Arsimin paqësor dhe profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e programit, kryesisht në përqindje të ngjashme, i drejtohen pedagogut/psikologut (72% janë pjesë e Arsimit paqësor: 74% nuk janë pjesë e Arsimit paqësor), kujdestarit të klasës (62%: 41%), drejtorit (34%: 21%) etj. Vërehet një tendencë që profesorët/eshat nga Arsimi paqësor të kërkojnë ndihmë prej më shumë vendeve (mesatarisht 2.3 vende), në krahasim me profesorët/eshat të cilët nuk janë pjesë e Arsimit paqësor (ndihmë nga 1.7 vende).

Këto të dhëna ilustron se në kuadër të Arsimit paqësor është punuar në rrjetëzimin dhe zhvillimin e vetëdijes për sistemet e përkrahjes për profesorët/eshat. Nga kjo mund të rrjedh edhe frekuenca më e lartë e përgjigjeve e të drejtuarit për ndihmë në shumë vende në mes profesorëve/eshave të cilët janë pjesë e Arsimit paqësor në krahasim me ata të cilët nuk janë. Me këtë në mënyrë empirike konfirmohet ndikimi pozitiv i Arsimit paqësor në drejtim të dhënies së përkrahjes ndaj profesorëve/eshave.

**Tabela 38**

Prej kujt kërkoni ndihmë në rast të dhunës?		Pjesë e Arsimit paqësor				Gjithsej	
		Po		Jo		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Pedagogut / psikologut	34	72	29	74	63	73
	Kujdestarit të klasës	29	62	16	41	45	52
	Drejtorit	16	34	8	21	24	28
	Vetë e zgjedhi problemin	12	26	10	26	22	26
	Profesorit/eshës tjetër	13	28	1	3	14	16
	Prindërve	1	2	1	3	2	2
	Askujt			1	3	1	1
	Policisë	1	2			1	1
	Nuk kam pasur situatë konflikti	1	2			1	1
	Total	47	228%	39	169%	86	201%

Këto gjetje dëshmojnë edhe një herë se bashkëpunëtorët profesionistë janë shtyllat e shkollave në Arsimin paqësor. Prandaj, kontributi i tyre duhet të vlerësohet në një mënyrë të përshtatshme. Gjithashtu, normativat për bashkëpunëtorët profesional duhet të jenë në përputhje me situatën aktuale, e cila tregon tendencë për përkeqësimin e gjendjes në shkolla.


### 13. Masat për zvogëlimin e dhunës në shkolla

Duke pasur parasysh se dhuna në shkolla në përgjithësi është sjellur në nivel të lartë, është e domosdoshme të ndërmerren masa konkrete sipas të cilave do të punohet për të zvogëluar dhunën sepse eliminimi i tërësishtëm i dhunës është i pamundur.


#### *Ndërmarrja e aktiviteteve për zvogëlimin e intolrancës ndëretnike dhe/ose dhunës (2011 -2019)*

Të rinjtë në përqindje më të lartë besojnë se klubet rinore/shkollore do ta përmirësojnë situatën në shkolla sa i përket tolerancës ndëretnike dhe/ose dhunën krahasuar në të tre hulumtimet (82% në 2011, 86% në 2012 dhe 82% në 2019). Veçse në vendin e dytë përqindjet ndryshojnë në raport me përqindjen e aktiviteteve që do të ndihmojnë më së miri në tejkalimin e jotolerancës dhe trazirave, kështu që në vitin 2011 - 81% e nxënësve/eve konsiderojnë se ajo do të ishte këshilli i nxënësve, në vitin 2012 78% e konsiderojnë të njëjtën, ndërsa në vendin e dytë janë mbledhjet e nxënësve në 2019 me 80%. Edhe pse vendndodhja e aktiviteteve të ndryshme që mund të ndërmerren për të përmirësuar situatën në shkolla nuk është e njëjtë çdo vit, dallimet në mes përqindjeve në të cilat janë të shprehura janë të parëndësishme, respektivisht diferencat janë më të vogla se mundësia e parashikuar e gabimit prej rreth +/- 5%. Nxënësit/et në të tre vitet konsiderojnë se petitionet deri tek drejtori janë përqindja më e ulët e suksesshme në zgjidhjen e këtyre problemeve (52% në 2011, 44% në 2012 dhe 55% në 2019). Në vitin 2019, punëtoritë ndëretnike renditen një vend më të lartë në listën e aktiviteteve prioritare, respektivisht 78% në vitin 2019 besojnë se këto aktivitete do ta përmirësonin situatën në shkolla, në vitin 2012 e konsiderojnë atë 67% të nxënësve, në vitin 2011 66% të nxënësve/eve e ndajnë të njëjtin mendim.


Grafiku 13



Grafiku 14



Grafiku 15



## Masa të cilat duhet t'i ndërmerret shkolla për zvogëlimin e dhunës (2019)

Nxënësve/eve u parashtruan edhe një pyetje të hapur: “Çka sipas mendimit tënd, duhet të ndërmerret në shkollë me qëllim që të zvogëlohet dhuna në mes bashkëmoshatarëve?”, të cilës ata u përgjigjën me sugjerimet e tyre ku në pjesë e madhe e përgjigjeve përmbajnë faktorë të cilat ata i theksonin në përgjigjet e tyre. Për këtë shkak u përpoqëm të vinë deri tek përgjigjet nëpërmjet të faktorëve kryesorë që i rendisin nxënësit në përgjigjet e tyre spontane, të cilat në fakt paraqesin koncepte që shërbejnë si bosht rreth të cilit përfshihen edhe faktorë të tjerë në kuadër të përgjigjes së nxënësit/es. Në këtë mënyrë praktikisht i de-tektoam përgjigjet më të shprehura të nxënësve/eve për atë se çka duhet të bëhet për të zvogëluar dhunën në shkollë. Për shkak se këto janë përgjigje spontane dhe nxënësit/et dhanë disa përgjigje të ndryshme, të gjitha përgjigjet e nxënësve/eve tregohen veçmas në shtojcën numër 3 si një mundësi për një analizë më të hollësishme. Tabela 39 më poshtë tregon kategori të sublimuara të përgjigjeve pa shfaqur frekuencën e tyre (paraqitje e shfaqjes së zgjidhjeve).

Nga këto përgjigje mund të bëjmë përmbledhje të caktuar të përgjigjeve të prezantuara në:

- zgjidhje dhe përgjigje pozitive dhe konstruktive
- zgjidhje ndëshkuese-restriktive
- zgjidhje dhe propozime tjera

**Tabela 39a**

<b>Zgjidhje pozitive dhe konstruktive</b>
Më shumë shoqërim, aktivitete, ekskurziona, aktivitete sportive
Të organizohen debate, mbledhje, klube
Bashkëpunim me psikolog, kujdestar klase, drejtor, prindër
Vetëdijësim se dhuna nuk zgjidh asgjë, edukim
Ligjerata që ndikojnë mbi sjelljen e dhunshme si dhe si t'i shmangemi dhunës
Punëtori ndëretnike kundër dhunës, fryma e tolerancës

**Tabela 39b**

<b>Zgjidhje ndëshkuese-restriktive</b>
Kontrollë nga profesorët, psikologët
Ndëshkime për profesorët
Të përjashtohen dhunuesit nëse nuk përmirësohen
Nuk mund të zvogëlohen / të parandalohen ngjarjet e dhunës
Asgjë, shkolla ka ndërmarrë gjithçka që duhet
Mos të takohen nxënës në mes ndërrimeve, mos të përzihen
Rregulla më të rrepta për sjelljen e nxënësve


**Tabela 39c**

<b>Zgjidhe dhe propozime tjera</b>
Të formohen këshilla të nxënësve
Është deri tek qëndrimet e nxënësve, dhuna është afirmim negativ
Shprehja e vlerave të vërteta
Të parandalohen ndodhi të dhunës
Të rritet siguri në shkollë, policia
Mos të ketë ndarje në mes nxënësve, mos të ketë diskriminim
Masa preventive, masa pedagogjike, përgjegjësi më e madhe

***Pjesëmarrja e nxënësve në aktivitete mësimore dhe jashtëmësimore (2019)***

Në hulumtimin e fundit, i pyetëm nxënësit/et në lidhje me aktivitetet e tyre lidhur me shkollën, në çka u përgjigjen se më së shpeshti vizitojnë ekskurzione (63%), projekte të caktuara (49%) dhe në listën e shpeshtësisë së aktiviteteve vizitore në vendin e tretë janë aktivitetet jashtëmësimore (27%). Përqindja më e lartë e nxënësve/eve asnjëherë nuk ndjekin koncerte (36%), shtesë (34%) ose mësim plotësues (33%).

**Grafiku 16**



***Ekzistimi i mekanizmeve për parandalimin e dhunës në mes nxënësve/eve (2019)***

Sipas të dhënave të marra nga përgjigjet e profesorëve/eshave të dhëna në lidhje me atë nëse ekzistojnë mekanizma me të cilët shkolla ballafaqohet me dhunën në mes nxënësve/eve, profesorët/eshat pavarësisht se a janë pjesë e Arsimit paqësor apo jo përgjigjen mënyrë e ngjashme, respektivisht se në rreth 90% të shkollave ekzistojnë mekanizma të tilla ndërsa në rreth 10% nuk ekzistojnë. Më hollësisht, nga 4 profesorë/



esha edhe nga shkollat homogjene edhe heterogjene u përgjigjën se nuk kishte mekanizma në shkollë për ta parandaluar dhunën në mes nxënësve.

**Tabela 40**

A ekzistojnë në shkollë mekanizma për parandalimin e dhunës në mes nxënësve?		Pjesë e Arsimit paqësor				Gjithsej	
		Po		Jo		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Po	43	91	34	87	77	90
	Jo	4	9	5	13	9	10
	Gjithsej	47	100%	39	100%	86	100%

Nga përgjigjet spontane, në të cilat profesorët/eshat shpjegojnë se cilat janë mekanizmat me anë të cilëve shkolla trajton dhunën në mënyrë të kategorizuar janë të veçuara përgjigjet se qaset drejt punëtorëve me psikologun, ose ora e kujdestarisë është edukim në këtë temë, më tutje, fjalim (adresim) i drejtorit, kujdestarit, pedagogut ose psikologut etj. Disa profesorë/esha shprehen në mënyrë të qartë se ekzistojnë mekanizma por janë joefektive, që do të thotë se këto mekanizma dhe funksionimi i tyre shpesh duhet të rishqyrtohen, ndërsa pothuajse çdo i/e katërti/a profesor/eshë nuk jep shpjegim për mënyrën e trajtimit të dhunës në shkollë.

**Tabela 41**

<b>Ka por jo mjaftueshëm, nuk është efektiv</b>
Profesorë/esha kujdestarë, sigurim shkollor dhe policor
Aktivitet jashtë-mësimorë të cilat do t'i afrojnë nxënësit
Protokol se si të veprohet në rast të çfarëdo lloji të dhunës
Bisedë me nxënësit dhe prindërit rreth shkaqeve të konflikteve
Drejtor, kujdestar klase, pedagog, psikolog
Punëtori me psikolog, ora e kujdestarisë si orë edukative

***Ndërmarrja e masave për zvogëlimin e dhunës në shkollë (2019)***

Ashtu si në pyetjen e mëparshme, edhe këtu, janë pyetur profesorët/eshat në cilat mënyra ata mendojnë se dhuna në shkollë duhet të zvogëlohet, spontanisht japin disa përgjigje të ndryshme të cilat më tej kategorizohen si përgjigje pa treguar shfaqjen e tyre për shkak të përsëritjeve të shumta të përgjigjeve të njëjta. Përgjigjet tregojnë se profesorët/eshat shfaqin gatishmëri për të zgjidhur dhunën përmes një diapazoni të gjerë përgjigjesh në lidhje me atë se si mund të zgjidhen. Përgjigjet më të shpeshta janë se shpesh duhet të bisedohet dhe debatohet me nxënësit/et, si dhe fakti që nevojitet edukim më intensiv i nxënësve/eve për mënyrat se si të shmaget dhuna (pa dallim se a janë ata kryeset potencial të dhunës ose viktimat). Poashtu vërehet edhe përgjigje në të cilën profesorët/eshat thonë se masat ndëshkuese nuk respektohen gjithmonë, respektivisht, ato zbatohen në mënyrë të barabartë për çdo dhunues, gjë që tregon se ekzistojnë marrëdhënie jo-objektive dhe të pabarabarta në shkollë ku favorizohen nxënës të caktuar, gjë që mund në mënyrë plotësuese ta përkeqësojë situatën në shkollë si nga aspekti i përforsimit të rolit të dhunuesve ashtu edhe nga aspekti i ndjenjës së padrejtësisë në mes viktimave të cilët prandaj mund të bëhen dhunues potencial në periudhën e ardhshme.


**Tabela 42**

Angazhimi i nxënësve me anë të aktiviteteve të ndryshme
Promvimi i jodhunës dhe zero-tolerancës ndaj dhunës
Biseda të shpeshta me nxënësit, debate
Të detektohen shkaqet për dhunë
Të ketë selektim dhe kualitet të nxënësve/eve, në bankat shkollore duhet të jenë nxënësit/et të cilët kanë dëshirë për të mësuar
Të edukohen në temë zgjidhja e konflikteve, paragjytimeve, bullingut
Masat ndëshkuese të respektohen pa dallim se kush është dhunuesi
Bashkëpunim në mes faktorëve brenda në shkollë dhe komunikim transparent
Prindërit të punojnë më shumë me fëmijët e tyre
Përfshirja e Arsimit paqësor në orët e kujdestarisë

## 14. Vlerësimi për rritjen / zvogëlimin e dhunës në shkollë (2019)

Përshtypja e përgjithshme e profesorëve/eshave në lidhje me atë se a është zvogëluar ose nuk është zvogëluar dhuna në shkollë prej kur implementohet Programi i arsimit paqësor, është se dhuna është duke u zvogëluar (68%). Rreth 29% e profesorëve/eshave besojnë se dhuna mbetet e pandryshuar ndërsa vetëm 2% e profesorëve/eshave e perceptojnë atë si të rritur.

**Grafiku 17**



Shikuar nga prizma e pjesëmarrjes në Arsimin paqësor të profesorëve/eshave, mund të shohim bazuar në rezultatet se trajtimi i kësaj problematike rezulton në vetëdijen se dhuna është zvogëluar, ndërsa nga ana tjetër këta profesorë/esha kanë pasqyrë tek rezultatet për shkak të përfshirjes së tyre në Programin e arsimit paqësor dhe mund të bëjë një krahasim me të kaluarën, për dallim nga profesorët/eshat të cilët nuk janë të përfshirë në këtë program. Përkatësisht, 77% e profesorëve/eshave të përfshirë në program besojnë se dhuna ka rënë në krahasim me profesorët/eshat të cilët nuk janë të përfshirë në këtë program (59%). Pavarësisht nga këto dallime, shumica e profesorëve/eshave nga të dy kategoritë besojnë se dhuna është zvogëluar. Si të pandryshuar dhunën e perceptojnë nga një përqindje më e lartë e profesorëve/eshave të cilët nuk janë të përfshirë në Arsim paqësor (38%) ndërsa profesorët/eshat e përfshirë në një përqindje më të ulët prej tyre (21%).

**Tabela 43**

A konsideroni se dhuna në shkollën tuaj në krahasim me periudhën para fillimit të Programit për arsim paqësor është:		Pjesë e arsimit paqësor				Gjithsej	
		Po		Jo		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Zvogëluar	36	77	23	59	59	69
	Rritur	1	2	1	3	2	2
	Nuk ka ndryshuar	10	21	15	38	25	29
	Gjithsej	47	100%	39	100%	86	100%

### *Pjesëmarrja në Programin për arsim paqësor (2019)*

Nga të gjithë 86 profesorët/eshat e anketuar/a (vetëm një profesor/eshë nuk është shprehur se a është pjesë e Arsimit paqësor) nga shkollat në të cilat është i përfshirë Arsimi paqësor nën udhëheqjen e Ambasadës së arë të fëmijëve në botë - Megjashi, në shkollat e tipit heterogjen gjysma e profesorëve/eshave janë të përfshirë ndërsa gjysma tjetër nuk janë të përfshirë në Arsimin paqësor. Pak është më e ndryshme struktura e profesorëve/eshave të cilët iu përgjigjën pyetësorit nga shkollat të tipit homogjen ku rreth dy të tretat (66%) e profesorëve/eshave janë pjesë ndërsa një e treta (34%) nuk janë pjesë e Arsimit paqësor.

**Tabela 44**

A jeni pjesë e Programit për arsim paqësor i cili realizohet në shkollë në bashkëpunim me Ambasadën e parë të fëmijëve në botë - Megjashi?		Shkollë (Shkolla M+ / Shq, M+ dhe Shq)				Gjithsej	
		Shkollë M+ (Maqedonas dhe tjerë) / shkolla A (vetëm Shqiptarë)		Shkollë (M+ dhe Shqiptarë)		Numri	Kol %
		Numri	Kol %	Numri	Kol %		
2019	Po	19	66	28	50	47	55
	Jo	10	34	28	50	38	45
	Gjithsej	29	100%	56	100%	85	100%

## **15. Përmbledhja e gjetjeve kryesore prej hulumtimeve**

Intenca kryesore e analizave për të gjithë hulumtimet e kryera deri më tani në periudhën nga viti 2011 e deri në vitin 2019 ishte që mbi një bazë empirike të fituar me anë të hulumtimeve të bëhet një vlerësim i kontributit të Arsimit paqësor në shkollat e mesme të përfshira nga hulumtimet.

Gjetjet bazike tregojnë se dy faktorë kyç tregojnë një proces të vazhdueshëm të përmirësimit. Në mes nxënësve të grupeve të ndryshme etnike vazhdimisht rritet edhe frekuenca e komunikimit edhe gjithëpërfshirja në mes tyre. Këta dy tregues së bashku e ndryshojnë klimën në mes nxënësve në kahje pozitive me kalimin e kohës. Treguesit e pranisë së tensioneve ndëretnike dhe incidenteve tregojnë se ato rriten në vitin 2019 krahasuar me vitet 2011 dhe 2012. Por, kur analizohen të dhënat se a janë nga Shkupi prej ndonjë qytetit nga brendësia, arrihet në përfundim se edhe në vitin 2019 në Shkup variacionet për praninë e tensioneve ndëretnike dhe incidentet janë në varg që sugjerojnë konkludimin se ndryshimet në përgjithësi kanë tendencë të zvogëlohen. Mirëpo, të dhënat për shkollat jashtë Shkupit tregojnë se tek perceptimet e nxënësve/eve dominon prania e tensioneve dhe incidenteve, në krahasim me mungesën e tyre. Prandaj, zgjerimi i mostrës, në hulumtimin më të ri edhe për shkollat jashtë Shkupit, u tregua i justifikuar dhe i përshtatshëm. Në këtë mënyrë, u krijuan kushte në një radius më të gjërë që të perceptohen fenomenet e dhunës. Në raste të tjera, tregohet se nuk ka dallime domethënëse në mes perceptimeve brenda dhe jashtë Shkupit, gjë që na jep bazë për të parë se fenomeni i një aspekti të caktuar të dhunës është i përhapur në

